



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Glllogocit**  
Zyra e Kryetarit



01-Nr 030-2126 dt. 10.01.2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika (h), të Ligjit për Veteqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunes së Drenasit, Kryetari i Komunes së Drenasit propozon që në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2, të Ligjit për Veteqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_.1.2023 të aprovojë këtë:

**PROPOZIM VENDIM**  
**Për Miratimin e Simbolit Përkujtimor të Gjenocidit në Kosovë**

**Neni 1**

Kuvendi i Komunës së Drenasit, të miratojë Propozimin që „Lulëkuqja me katër petale“ të behet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

**Neni 2**

Simboli si në nenin 1, të këtij Propozim Vendimi, paraqet katër format e akteve gjenocidale që Republika e Serbisë zbatoi në Republikën e Kosovës, si: vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

**Neni 3**

Pjesë e këtij Propozim Vendimi është simboli i propozuar.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës  
Ramiz Lladrovci

## ARSYETIM

Kryesia e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur, me datë 6.1.2023 i janë drejtuar Komunës së Drenasit me kërkesë si në këtë propozim vendim dhe arsyetim si më poshtë:

Sqarim lidhur me propozimin që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë

Kërkesa publike drejtuar institucioneve shtetërore dhe politike të Kosovës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol i vetëm përkujtimor i gjenocidit në Kosovë, ka gjetur mbështetje të gjithanshme dhe shfrytëzohet rastin të falënderojmë përzemërsisht të gjithë përkrahësit e kësaj iniciative. Megjithatë nga disa dashamirë na është kërkuar të tregojmë arsyet e përzgjedhjes së lulëkuqes, për ta propozuar si simbol të gjenocidit në Kosovë.

Prandaj sqarojmë me sa vijon:

Po bëhet një shekull që në Mbretërinë e Bashkuar, në Kanada, në Skoci, në SHBA dhe në Zelandë të Re, lulëkuqet kanë shërbyer si simbol për t'i përkujtuar të rënët gjatë luftërave anekënd globit dhe secili nga këto shtete demokratike ka përcaktuar një dizajn të veçantë të lulëkuqes, për ta dalluar nga simbolet-lulëkuqe të vendeve të tjera.



**KANADA**



**MBRETËRIA  
E BASHKUAR**



**SKOCIA**



**ZELANDA E RE**




**SHBA**



**PROPOZIMI  
PËR KOSOVËN**

Po përmendim se edhe popuj të tjerë kanë përzgjedhur lule të ndryshme për simbol të përkujtimit të viktimave. Kështu për shembull, francezët zgjedhën lulen kokoçel i kaltër, për arsye të ngjyrës

së kaltër që kishin uniformat e ushtarëve të vrarë, ndërkaq armenët u përcaktuan për lulen mosmëharro (lulja miosotis) për të përkujtuar viktimat e gjenocidit që kanë përjetuar në vitin 1915.



Lulja kokoçel i kaltër që u bë simbol përkujtimi në Francë.



Lulja mosmëharro (miosotis) që u bë simbol përkujtimi për viktimat e gjenocidit armen.

Pasi analizuam propozime të ndryshme, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur” mbështeti idenë e Adnan Asllanit që *lulëkuqja* të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë.

Duke u nisur nga fakti se në përkufizimin e gjenocidit hyjnë aktet kriminale të numëruara në dokumentet e të drejtës penale ndërkombëtare që janë bërë me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si i tillë, ne jemi përcaktuar për lulëkuqen që ka ngjyrat kuq e zi të flamurit tonë kombëtar, sepse projekti i gjenocidit në Kosovë kishte për qëllim shkatërrimin e shqiptarëve, si grup kombëtar, i ndryshëm nga serbët.

Pikërisht për këtë arsye ngjyra e petaleve të lulëkuqes që do të simbolizojë gjenocidin në Kosovë dallon nga nuancat e ngjyrave të kuqe që kanë lulëkuqet-simbole të shteteve të lartpërmendura: është ngjyra e gjakut të pafajshëm!

Përveç nuancës së ngjyrës së kuqe të petaleve që e dallon nga ngjyra e petaleve që kanë *lulëkuqet-simbol* të vendeve të tjera, në simbolin e gjenocidit në Kosovë dallon edhe “zemra e lulëkuqes”: në vend të kokrrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për të kujtuar njerëzit e të gjitha moshave dhe të dy gjinive që ishin viktimat të këtij gjenocidi.

Në dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në vendet e lartpërmendura, katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar prej tij paraqesin katër forma të akteve gjenocidare, që Serbia e zbatoi në Kosovë:

**1. Vrasje**

Për të përfshirë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe gjinive,

**2. Dhuna seksuale**

Për të përfshirë mbi njëzet mijë viktima të dhunës seksuale.

**3. Spastrimi etnik**

Për të përfshirë rreth një milion viktima të spastrimit etnik.


**4. Shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar**

Për të përfshirë shkatërrimi në vendbanimet shqiptare i 100589 shtëpive, i 358 shkollave, i 30 shtëpive kulturore, i 93 bibliotekave, i 123 institucioneve shëndetësore dhe i 220 objekteve të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbe dhe 5 kisha katolike).

Petalet e lulëkuqes në këtë logo janë të vendosura në formë të shkronjës X, për arsye se gjatë luftës, në disa vendbanime ku popullsia ishte e përzier në aspektin e përkatësisë etnike, okupatorët serbë kishin shënjuar shtëpitë e shqiptarëve me një X, me qëllim që të udhëzoheshin forcat e armatosura serbe drejt vendeve ku duhej të kryheshin krimet.

Me një fjalë, forma e petaleve dhe figurat e burrave, grave, djemve dhe vajzave simbolizojnë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe të dy gjinive, mbi njëzet mijë viktima të dhunës seksuale, rreth një milion viktima të spastrimit etnik dhe qindra mijëra shkatërrime që u kryen gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë.

Si e tillë, kjo logo meriton të jetë simbol i përbashkët i përkujtimit të viktimave të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës.



GJENOCIDI NË KOSOVË – PLAGË E HAPUR  
1200 Genève  
E-Mail: info@kosovogenocide.com  
Online: www.kosovogenocide.com

PRESIDENTES SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PARTIVE POLITIKE TË KOSOVËS

## KËRKESË

# LULËKUQJA ME KATËR PETALE TË BËHET SIMBOL UNIK PËRKUJTIMOR I GJENOCIDIT NË KOSOVË


### ARSYETIM:

Në disa vende të botës, së paku prej një shekulli, lulëkuqet kanë shërbyer si simbol për të përkujtuar të rënët gjatë luftërave anekënd globit. Kështu, për shembull, në Britanihë e Madhe dhe në disa vende të Komonuelthit, *lulëkuqja*, me ngjyrën e saj të gjakut, është simbol i përkujtimit të luftëtarëve të rënë në fushëbeteja, veçanërisht të rënëve gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe i solidarizimit me familjet e tyre. Edhe kanadezët e kanë përcaktuar këtë lule si simbol të premtimit, që do t'i përkujtojnë dhe që nuk do t'i harrojnë kurrë, ata të cilët u sakrifikuan për lirinë e vendit. Përkujtimi i të rënëve në Kanada bëhet çdo vit në orën 11:00, në ditën e 11-të të muajit të 11-të.



[www.kosovogenocide.com](http://www.kosovogenocide.com)


Që nga viti 1922, edhe Franca, më 11 nëntor të çdo viti përkujton viktimat e Luftës së Parë Botërore. Francezët kanë zgjedhur lulen e *kokoçelit të kaltër*, për arsye të ngjyrës së kaltër që kishin uniformat e ushtarëve të vrarë, si simbol nderimi ndaj të gjithë atyre që kishin dhënë jetën për lirinë e Francës.



Madje edhe në përkujtim të viktimave të Luftës së Dytë Botërore, që u përcaktua të bëhet çdo vit më datë 8 maj, *kokoçeli i kaltër* mbeti simboli kombëtar i Francës.

Pas konsultimeve të shumta, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur” mbështeti idenë e Adnan Aslanit, që *lulëkuqja* të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë. Në dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në shumë vende të tjera, katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar prej tij paraqesin katër format e akteve gjenocidare, që Serbia zbatoi në Kosovë:

1. vrasjen,
2. dhunën seksuale,
3. spastrimin etnik dhe
4. shkatërrimin e objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.



Përveç domethënies së veçantë që ka çdo petal i simbolit tonë dhe që e dallon nga forma e petaleve që kanë *lulëkuqet-simbol* të vendeve të tjera, në simbolin e gjenocidit në Kosovë dallon edhe “zemra e lulëkuqes”: në vend të kokrrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë janë paraqitur figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për të kujtuar njerëzit e të gjitha moshave dhe gjinive, që ishin viktimat të këtij gjenocidi.

Petalet e lulëkuqes në këtë logo janë të vendosura në formën e shkronjës X, për arsye se gjatë luftës, në disa vendbanime ku popullsia ishte e përzier në aspektin e përkatësisë etnike, okupatorët serbë kishin shënjuar shtëpitë e shqiptarëve me një X, me qëllim që forcat e armatosura serbe të udhëzoheshin drejt vendeve ku duhej të kryeshin krimet.

Me një fjalë, forma e petaleve dhe figurat e burrave, grave, djemve dhe vajzave simbolizojnë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe gjinive, mbi njëzet mijë viktimat të dhunës seksuale, rreth një milion viktimat të spastrimit etnik dhe qindra mijëra shkatërrimeve që u kryen gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë.

Si e tillë, mendojmë se kjo logo meriton të jetë simbol i përbashkët i përkujtimit të viktimave të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Meqë jemi në prag të 15 janarit, ditës së përkujtimit të gjenocidit në Kosovë, përcaktimi nga institucionet tona shtetërore i një simbol unik, që mishëron këtë tragjedi kombëtare, është mënyra më e mirë për të përçar mesazhin e unitetit përballë krimit të gjenocidit - plagës së hapur në qenien tonë kombëtare.

Gjenevë, më 16 nëntor 2022

Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur”

Kryetar

Bardhyl Mahmuti

## Sqarim lidhur me propozimin që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë

Kërkesa publike drejtuar institucioneve shtetërore dhe politike të Kosovës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol i vetëm përkujtimor i gjenocidit në Kosovë, ka gjetur mbështetje të gjithanshme dhe shfrytëzojmë rastin të falënderojmë përzemërsisht të gjithë përkrahësit e kësaj iniciative. Megjithatë nga disa dashamirë na është kërkuar të tregojmë arsyet e përzgjedhjes së lulëkuqes, për ta propozuar si simbol të gjenocidit në Kosovë.

Prandaj sqarojmë me sa vijon:

Po bëhet një shekull që në Mbretërinë e Bashkuar, në Kanada, në Skoci, në SHBA dhe në Zelandë të Re, lulëkuqet kanë shërbyer si simbol për t'i përkujtuar të rënët gjatë luftërave anekënd globit dhe secili nga këto shtete demokratike ka përcaktuar një dizajn të veçantë të lulëkuqes, për ta dalluar nga simbolet-lulëkuqe të vendeve të tjera.



**KANADA**



**MBRETËRIA  
E BASHKUAR**



**SKOCIA**



**ZELANDA E RE**



**SHBA**



**PROPOZIMI  
PËR KOSOVËN**

Po përmendim se edhe popuj të tjerë kanë përzgjedhur lule të ndryshme për simbol të përkujtimit të viktimave. Kështu për shembull, francezët zgjedhën lulen kokoçel i kaltër, për arsye të ngjyrës së kaltër që kishin uniformat e ushtarëve të vrarë, ndërkaq armenët u

përcaktuan për lulen mosmëharro (lulja miosotis) për të përkujtuar viktimat e gjenocidit që kanë përfunduar në vitin 1915.



Lulja kokoçel i kaltër që u bë simbol përkujtimi në Francë.



Lulja mosmëharro (miosotis) që u bë simbol përkujtimi për viktimat e gjenocidit armen.

Pasi analizuam propozime të ndryshme, Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" mbështeti idenë e Adnan Asllanit që *lulëkuqja* të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë.

Duke u nisur nga fakti se në përkufizimin e gjenocidit hyjnë aktet kriminale të numëruara në dokumentet e të drejtës penale ndërkombëtare që janë bërë me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si i tillë, ne jemi përcaktuar për lulëkuqen që ka ngjyrat kuq e zi të flamurit tonë kombëtar, sepse projekti i gjenocidit në Kosovë kishte për qëllim shkatërrimin e shqiptarëve, si grup kombëtar, i ndryshëm nga serbët.

Pikërisht për këtë arsye ngjyra e petaleve të lulëkuqes që do të simbolizojë gjenocidin në Kosovë dallon nga nuancat e ngjyrave të kuqe që kanë lulëkuqet-simbole të shteteve të lartpërmendura: është ngjyra e gjakut të pafajshëm!

Përveç nuancës së ngjyrës së kuqe të petaleve që e dallon nga ngjyra e petaleve që kanë *lulëkuqet-simbol* të vendeve të tjera, në simbolin e gjenocidit në Kosovë dallon edhe “zemra e lulëkuqes”: në vend të kokrrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për të kujtuar njerëzit e të gjitha moshave dhe të dy gjinive që ishin viktimat të këtij gjenocidi.

Në dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në vendet e lartpërmendura, katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar prej tij paraqesin katër forma të akteve gjenocidare, që Serbia e zbatoi në Kosovë:

**1. Vrasje**

Për të përfshirë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe gjinive,

**2. Dhuna seksuale**

Për të përfshirë mbi njëzet mijë viktimat të dhunës seksuale.

**3. Spastrimi etnik**

Për të përfshirë rreth një milion viktimat të spastrimit etnik.

**4. Shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar**

Për të përfshirë shkatërrimi në vendbanimet shqiptare i 100589 shtëpive, i 358 shkollave, i 30 shtëpive kulturore, i 93 bibliotekave, i 123 institucioneve shëndetësore dhe i 220 objekteve të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbe dhe 5 kisha katolike).

\*Petalet e lulëkuqes në këtë logo janë të vendosura në formë të shkronjës X, për arsye se gjatë luftës, në disa vendbanime ku popullsia ishte e përzier në aspektin e përkatësisë etnike, okupatorët serbë kishin shënjuar shtëpitë e shqiptarëve me një X, me qëllim që të udhëzoheshin forcat e armatosura serbe drejt vendeve ku duhej të kryheshin krimet.

Me një fjalë, forma e petaleve dhe figurat e burrave, grave, djemve dhe vajzave simbolizojnë mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe të dy gjinive, mbi njëzet mijë viktimat të dhunës seksuale, rreth një milion viktimat të spastrimit etnik dhe qindra mijëra shkatërrime që u kryen gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë.

Si e tillë, kjo logo meriton të jetë simbol i përbashkët i përkujtimit të viktimave të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

11 dhjetor 2022

Kryesia e Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur”

Kryetar

Bardhyl Mahmuti

Zëvendës Kryetar

Adnan Asllani



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarsvo Lokalne Samouprave Administracije  
Ministry of Local Government Administration

# RAPORT I PERFORMANCËS SË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4897 64986 0266 7654 6789 7482 5489 4897 64986 0266 7654 4897 64986 4897 64986  
0266 7654 6789 7482 5489 4897 64986 0266 7654 4897 64986 4897 64986 0266 7654  
6789 7482 5489 4897 64986 0266 7654 4897 64986 4897 64986 0266 7654 6789 7482  
5489 4897 64986 0266 7654 4897 64986 4897 64986 0266 7654 6789 7482 5489 4897  
64986 0266 7654 4897 64986 4897 64986 0266 7654 6789 7482 5489 4897 64986 0266  
7654 4897 64986 64986 4897 64986 0266 7654 6789 7482 64986 4897 64986 0266 7654

J A N A R – D H J E T O R 2 0 2 1

**Institucioni:**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Mbikëqyrja:**

Venera Çerkini, zv. Sekretare e Përgjithshme, MAPL

**Pjesa e përgjithshme hartuar nga:**

Diellor Gashi, Udhëheqës i Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale;

**Pjesa e veçantë nga:**

Lazar Mitic & Haxhi Krasniqi

**Mbledhja, përpunimi, verifikimi i të dhënave:**

Flurim Arifi, zv. Udhëheqës i Divizionit për Performancë Komunale

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Haxhi Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MPL

Shqiponja Vokshi, DEMOS

Arbrnor Imeri – Konsulent/DEMOS

Donjeta Morina – Konsulente/DEMOS

Copyright 2022

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të autorit - MAPL.*

## Përmbajtja

HYRJE.....	4
BAZA JURIDIKE PËR RAPORTIN E PERFORMANCËS.....	4
QËLLIMI.....	5
METODOLOGJIA.....	6
Kapitulli I.....	7
I. Performanca e komunave 2021 – Pjesa e Përgjithshme.....	7
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MATJES SË PERFORMANCËS KOMUNALE.....	7
2. TRENDET E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE NDËR VITE.....	8
REZULTATET E VITIT 2021.....	9
Kapitulli II.....	17
II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2020.....	17
1. REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE.....	17
Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative.....	17
Fusha 2 – Transparenca Komunale.....	19
Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale.....	20
Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare.....	22
Fusha 5 – Kulturë, Rinë dhe Sport.....	23
Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive.....	24
Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor.....	25
Fusha 8 – Hapësirat Publike.....	26
Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore.....	27
Fusha 10 – Transporti Publik.....	29
Fusha 11 – Parkingjet Publike.....	30
Fusha 12 - Uji i pijshëm.....	31
Fusha 13 - Kanalizimi.....	32
Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave.....	33
Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit.....	34
Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinnor.....	34
Fusha 17 - Arsimi Parauniversitar.....	36
Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor.....	38
Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal.....	39
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	41
SHTOJÇË: % E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE.....	44

## Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2021 prezanton rezultatet e punës së komunave në 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 104 treguesve nga 119 sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Për vitin 2021, raporti përmbledh 7 tregues më shumë se për vitin 2020, për shkak të reduktimit të masave të pandemisë dhe reflektimit të tyre në punën e institucioneve lokale. Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm dhe pezulluar 10 prej tyre.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet e vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Për vitin 2021 kanë raportuar 37 komuna të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>.

## Baza juridike për raportin e performancës

Matja e performancës komunale tashmë është ngritur në nivel të rregullimit ligjor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Ligjin Nr. 08/l-103 për Sistemin e Menaxhimit të

---

<sup>1</sup> Të dhënat nuk janë raportuar nga Komuna e Skenderajt

Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 12.08.2022.

Bazuar në 36 të këtij ligji, matja e performancës dhe vlerësimi për grant për periudhën e vitit 2021, është bërë konform Rregullores Nr. 01/2020 për SMPK dhe GPK. Për më saktë, ky nen ka përcaktuar se *“Procedurat e filluara për matjen e performancës dhe vlerësimin për grant para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vendosen dhe përfundojnë në pajtim me rregullat juridike paraprahe në fuqi”*.

Referuar Rregullores Nr.01/2020, SMPK është i ndërtuar mbi parimeve themelore siç janë: Ligjshmërisë; Transparencës; Subsisdiaritetit, meritës; efikasitetit dhe efektivitetit; Vlefshmërisë; Barazisë; Zbatueshmërisë.

Rregullorja përcakton të drejtën e autoritetit mbikëqyrës për të kërkuar informata të cilat i shërbejnë matjes dhe vlerësimin të performancës së komunave. Rregullorja përcakton strukturat organizative përgjegjëse të komunave për raportim në kuadër të SMPK-së.

## Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve e komunave brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kriterëve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.

## Metodologjia

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është i ndërtuar nga MAPL në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtar. MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

1. Funksionalizimin e sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të performancës dhe mbajtjen e trajnimeve për të gjithë zyrtarët e komunave;
2. Identifikimin e treguesve të performancës të ndikuar nga COVID-19;
3. Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
4. Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
5. Shqyrtimin fillestar të të dhënave dhe verifikimin paraprak;
6. Dërgimin e kërkesave për dokumentim shtesë në komuna;
7. Riverifikimin pas dërgimit të dëshmive plotësuese nga komunat;
8. Verifikimin e të dhënave me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në teren;
9. Nxjerrjen dhe komunikimin e rezultateve të performancës në komuna;
10. Përmbylljen e periudhës së ankesave;
11. Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së nga komunat, pas udhëzimeve/trajnimeve të organizuara nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

**Verifikimi i të dhënave** – sigurimi i cilësisë së të dhënave dhe verifikimi i tyre është bërë përmes disa metodave:

- Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;
- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Shqyrtimit të dokumenteve shtesë të kërkuara për të dhëna të caktuara në procesin e riverifikimit;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Krahasimit me raportet e tjera zyrtare të MAPL-së;

- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna.

## Kapitulli I

### I. Performanca e komunave 2021 – Pjesa e Përgjithshme

#### 1. Vështrim i përgjithshëm i matjes së performancës komunale

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt i cili implementohet në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancë dhe kryetarët e komunanve, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Matja shtrihet brenda kornizës së kompetencave të komunave sipas legjislacionit bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të

mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, në mënyrë që nga informacionet e fituara, të ndërtohen strategji për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2021 është realizuar në 19 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 109 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore<sup>2</sup>. Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhmetin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe në vitin 2021 procesi i matjes së performancës komunale është me anë të Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

## 2. Trendet e performancës së komunave ndër vite

Në vitin 2021, kërkesës për raportim të performancës u janë përgjigjur 37 komuna. Rezultatet e tregojnë se niveli i të arriturave të komunave ndër vite varion prej 56% deri në 66%.

Duhet cekur se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht shtimit të treguesve dhe të dhënave të reja. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale. Kjo rrije po ashtu është bërë për faktin se komunat kanë forcuar kapacitetet e tyre për përdorimin e sistemit të performancës, duke rritur kualitetin e të dhënave të raportuara. Analizat e përgjithshme tregojnë se disa tregues tanimë kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, që dëshmojnë për nivel të rregullsisë brenda rezultateve të synuara. Në anën tjetër ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunat akoma qëndrojnë në nivel të ulët të zhvillimit, për të cilët treguesit e matjes duhet të jenë prezent në një periudhë afatgjatë.

Më poëshhtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2017 deri në vitin 2021, si në vijim:

---

<sup>2</sup> Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, neni 5.1.1




Fig.1. Performanca e komunave sipas viteve 2017-2021

### Rezultatet e vitit 2021

Sa i përket të dhënave për vitin 2021, performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 109 tregues të matjes është 56.8%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime në më të uëlt për 0.26% krahasuar me 2020. Mesatarja e përgjithshme tregon se komunat duhet të rrisin përpjekjet tyre për të përmirësuar shërbimet dhe qeverisjen. Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehjet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (38.02%), kanalizim (35.49%), parkingje (47.04%), zhvillim ekonomik lokal (44,45%), planifikim hapësinor, shërbime shëndetësore, hapësira publike dhe infrastrukturë.

Më poshtë është paraqitur figura me % e arritur të 19 fushave të matjes:

## Fushat e performancës

SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	81.66
KULTURË RINI DHE SPORT	74.81
MENAXHIMI I MBETURINAVE	70.15
UJI I PUJSHËM	67.35
TRANSPARENCA KOMUNALE	66.92
MBROJTJA E AMBIENTIT	63.61
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	61.67
ARSIMI PARAUNIVERSITAR	58.39
MESATARJA	56.80
TRANSPORTI PUBLIK	56.64
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	55.09
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	53.97
INFRASTRUKTURA RRUGORE	52.04
KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR	51.14
HAPËSIRAT PUBLIKE	50.35
PLANIFIKIMI HAPSINOR	50.35
PARKINGJET PUBLIKE	47.04
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	44.55
PËRFAQËSIMI GJINOR	38.02
KANALIZIMI	35.49

Për shkak të mosraportimit të të dhënave në një numër të konsiderueshëm të fushave, rezultatet e fituara nuk janë të plota në disa komuna si: Zubin Potok (0.15%), Mitrovicë Veriore (1.51%), Kllokot Zveçan (2.08%), Leposaviq (1.02%) Novobërdë (20.84%), Mamushë (25.77%), Kllokot (10.64%), Partesh (3.13%) dhe Graçanicë (27.53%). Mungesa e të dhënave dhe cilësia e dobët e raportimit në këto komuna, jo vetëm që nuk pasqyron mjaftueshëm nivelin e të arriturave në kuadër të treguesve të matjes, por ndikon edhe në rezultatet e Grantin e Performancës. Kjo reflekton në shumat e financimit të cilat do të mund të alokoheshin në këto komuna në rast se do të raportonin në të gjithë treguesit dhe në rast se do të përmbushnin edhe kriteret e tjera minimale të përcaktuara në Rregullat e Grantit për Performancë.

Në vijim është paraqitur figura me të arriturat e komunave në 19 fusha të kompetencave për të cilat bëhet matja e performancës për vitin 2021. Performanca maksimale sipas fushës specifike është 81.66% (tek shërbimet administrative), kurse më e ulëta shprehet tek fusha e kanalizimit me (35.49%). Grupimi i fushave është bërë sipas nivelit të performancës të ndarë në tri nivele: i lartë 66-81%, i mesëm 46-66% dhe i ulët < 40%.

## Kategorizimi i fushave sipas %





Fig. 2 Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kometencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) Standardet e qeverisjes së mirë dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve publike.

**1) Fushat dhe treguesit e qeverisjes**, përfshijnë të dhëna rreth respektimit të standardeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, përfshirjes aktive të qytetarëve, standardeve të konsultimit publik si dhe çështje të ngjashme. Treguesit e kësaj kategorie kryesisht mbulojnë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, planifikimin e pronës, punësimin, rregullativën ligjore për të drejtat e komuniteteve, personave me aftësi të veçanta, përfaqësimin gjinor shërbimeve sociale etj.

Fig.3. % e arritur në fushat e qeverisjes



Nga figura 3 vërejmë që në kuadër të treguesve të qeverisjes, në vitin 2021 mesatarja është 56.70%, nga 59.11% sa ishte në vitin 2020. Krahasuar me vitin paraprak, të dhënat tregojnë se komunat kanë rritur efikasitetin në ofrimin e *shërbimeve administrative*, prej 74.42% në 81.66%, apo 7.24% më shumë. Në kuadër të kësaj fushe vlerësohet efikasiteti i komunave në kthimin e përgjigjeve palëve në procedurë administrative, trajtimit të tyre brenda afateve ligjore si dhe ofrimit të shërbimeve administrative në formë elektronike<sup>3</sup>.

Në kuadër të *Transparencës komunale*, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 66.92%, nga 77.62% sa ishte në vitin 2020, apo 10.7% më e ulët. Sipas të dhënave, për 3.14% komunat shënojnë ngritje në treguesit e përfaqësimit të barabartë gjinor, megjithëse mbetet ndër fushat me përqindjen më të ulët (38.02%).

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e *përgjegjshmërisë komunale*, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Për dallim nga treguesit e transparencës të cilët kryesisht janë të orientuar në ofrimin e publicitetit për aktivitetet dhe të dhëna zyrtare, përgjegjshmëria komunale inkorporon të dhëna që tregojnë për nivelin e llogaridhënies së organeve komunale, si dhe aktivitet e tyre për përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përderisa komunat qëndrojnë mjaft mirë në treguesit e transparencës, rezultatet e përgjegjshmërisë tregojnë për nevojën e fuqizimit të elementeve të llogaridhënies dhe përfshirjes më të madhe të qytetarëve. Kjo fushë rezulton me 53.97%, duke pësuar rënie prej 6.7% krahasuar me vitin paraprak. Edhe më tutje komunat qëndrojnë jo mirë në zbatimin e rregullave për standardet minimale të konsultimit publik 4.65%. Rëndësia e zbatimit të këtyre standardeve qëndron në përmirësimin e planifikimit të politikave, mbështetjen e tyre në informata të vlefshme dhe nevoja reale, për të siguruar shpërndarje të drejtë të investimeve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

<sup>3</sup> Per me teper: <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale-designed-18.02.2021.pdf>, fq. 62

Në kuadër të veprimeve që *ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal* komunat kanë përmirësuar performancën për 2.69%, me nivel të përgjithshëm të të arriturave në shkallën 44.55%, krahasuar me vitin 2020 sa ishte 41.86%<sup>4</sup>. Derisa në vitin 2020 vetëm 9 komuna argumentuan të kenë në fuqi Planet për zhvillim ekonomik lokal, në vitin 2021 këto plane janë evidentuar në 12 komuna. Po këtë vit, 13 komuna kanë ndërmarrë veprime për publikimin e listës së pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, sipas dispozitave të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Në të njëjtën kohë, komunat kanë arritur që standardin e verifikimit prej 20% me qëllim të mbledhjes së tatimit në pronë ta përmbushin në shkallë prej 72.09%, apo 14.48 më shumë se në vitin 2020 sa ishte 57.61%. Në anën tjetër, 41.09% është raportuar niveli i përgjithshëm i mbledhjes së tatimit në pronë, për 0.91% më pak se në vitin 2020 (pa borxhe, interesa, ndëshkime).

*Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare* - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cënueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 55.09% krahasuar me 65.23% të vitin paraprak. Bazuar në Ligjin Nr.03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përrkatësisht nenin 12, “çdo institucion publik duhet të ketë të punësuar një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punonjës (apo 2% e të punësuarve)”. Sipas të dhënave të vitit 2021, ky kriter ligjor është përmbushur në shkallën prej 23.67%, për dallim nga viti 2020 sa ishte 21.69%. Ndërsa, sa i përket përmbushjes së kriterit ligjor për punësimin e komuniteteve joshumicë, respektivisht nenit 9 të Ligjit për zyrtarët publik me të cilin kërkohet që plotësimi i vendeve të punës në nivel komunal të bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës së asaj komune, të dhënat tregojnë për 58.13% të përmbushjes së këtij kriteri. Të dhënat e analizuara për strehimin familjar theksojnë se në vitin 2021 komunat kanë arritur t’i përgjigjen kërkesave të qytetarëve në shkallën 47.92%, krahasuar me 62.30% të vitit 2020.

## *2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.*

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: menaxhim të mbeturinave, furnizim me ujë, mbrojtje të ambientit, kanalizim, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, mirëmbajtje të rrugëve, shtigje të biçikletave, parkingje publike, shenjëzim të rrugëve etj. Nga figura 4 rezulton që në kuadër të treguesve të shërbimeve publike, mesatarja e përgjithshme e arritur është 56.8%.

<sup>4</sup> Në këtë % të ulët ka ndikuar mungesa e Planeve për zhvillim ekonomik lokal, i cili është një nga indikatorët e kësaj fushe, i përmbushur në vetëm 9 komuna.

aktiviteteve të planifikuara në këtë fushë janë realizuar, për dallim nga viti paraprak ku ishin realizuar 35.32% të projekteve.

Në anën tjetër, 80.28% është niveli përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, sipas të dhënave valide të 31 komunave. Gjithashtu, të dhënat për këtë vit tregojnë se komunat, kanë përbushur 72.40% orarin për grumbullimin e mbeturinave sipas planeve të tyre. Sipas të dhënave të 30 komunave që kanë dokumentuar nivelin e inkasimit të obligimeve ndaj operatorëve të mbeturinave, lë ariturat pasqyrohen në nivel prej 89% të mjeteve. Shkalla e deponimit të mbeturinave vlerësohet në 50.62%, krahasuar me kriterin e marrë sipas standardeve të BE-së prej 300 kg për person në vit.

Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, komunat janë kompetente edhe për fushën e infrastrukturës lokale, zhvillimit ekonomik lokal, mbrojtjes së ambientit, menaxhimit të fatkeqësive, planifikimit urban, pronës komunale, arsimit dhe shëndetësisë. Të dhënat për *infrastrukturën rrugore* tregojnë për 52.04% të të arriturave në këtë fushë. 81.78% e rrugëve lokale konsiderohen të shtrura sipas të dhënave valide të 29 komunave, për dallim nga viti paraprak sa ishte 76.04%. Në anën tjetër, 62.6% e rrugëve janë mirëmbajtur në 26 komuna që kanë ofruar të dhëna të dokumentuara, krahasuar me 58.76% në vitin paraprak. Mirëmbajtja dimërore shprehet në shkallë prej 68.03%. Krahasj tyre, 22.39% e rrugëve të 24 komunave që kanë raportuar, janë të përcjella me trotuare, për dallim nga viti paraprak sa ishte 20.69%. Komunat kanë përmirësuar edhe infrastrukturën e ndriçimit të rrugëve publike, e cila në vitin 2021 del të jetë në shkallë prej 46.33, apo 7.58% më e lartë se në vitin 2020. Po ashtu, të dhënat e 27 komunave që kanë raportuar, tregojnë për 60.92 të rrugëve të pajisuar me shenjzim vertikal e horizontal, për 7.92% më lartë se në vitin 2020.

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme ose harta zonale është në shkallë prej 8.05%, në 19 komuna të cilat kanë ofruar të dhëna për vitin 2021. Në 94% të rasteve komunat janë përgjigjur në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore (sipas të dhënave të vlefshme të 29 komunave). Në anën tjetër, 65.48 të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, krahasuar me 64.52% të një viti më parë. 79.74% e këtyre hapësirave janë të përcjella me ndriçim publik. Njëherësh komunat kanë raportuar Rreth 87% e vendbanimeve janë të raportuar të jenë të përfshira në shërbimin e transportit publik lokal në 24 komuna.

Sa i përket *menaxhimit të fatkeqësive*, kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 61.67%.

*Fusha e Arsimit parauniversitar* mbledh tregues të shumtë për kompetencat e komunave në krijimin e kushteve për edukimin dhe arsimimin e nxënësve, prioritetet e vëna në këtë sektor përmes planifikimit të buxhetit, nivelin e planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore,

rezultatet e nxënësve, kushtet teknike dhe higjienike në shkolla, pajisjet e klasave me mjete pune, digjitalizimin e shkollave, aspektet e sigurisë, kriteret për kualifikimin dhe licencimin e mësimitdhënësve, mbingarkesën në klasa, hapësirat shkollore etj. Në këtë fushë komunat kanë treguar performancë në shkallë prej 58.39%. Nisur nga niveli parafillor, të dhënat flasin për përfshirje tejet të ulët të fëmijëve nëpër çerdhe, e sidomos në zonat rurale, për shkak të mungesës së investimeve në këto zona. Shikuar sipas kriterit të matjes 1 çerdhe për 10 mijë banorë, të dhënat tregojnë për vetëm 0.61% të arritjes këtij kriteri. Në vitin raportues, të dhënat tregojnë për përmirësim të kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar. Derisa në vitin 2020 të dhënat në këtë tregues ishin në shkallë prej 57.49%, në vitin 2021 janë prezantuar me 66.77%. Në këtë pjesë përfshihen të dhënat për: mjetet e sallave të edukatës fizike, kabinetet, laboratorët, materialet shpenzuese, bibliotekat, orenditë e zakonshme shkollore, pajisjet elektrike, projektorë, tabelat elektronike etj. Për të gjitha këto, komunat pranojnë mjete financiare nga buxheti i rregullt publik, çoftë përmes grantit specifik për arsim, apo përmes ndarjeve buxhetore nga kategoria e të hyrave vetanake. Bazuar në të dhënat e vitit 2020, mesatarja e hapësirave shkollore në nivel vendi është 18 m<sup>2</sup> për kokë nxënësi në zonat rurale dhe urbane. Komunat kanë raportuar për 71.34 % të shkollave të pajisura me kabinete të TIK-ut, për dallim nga viti 2020 që shprehej me 61%. Po ashtu, të dhënat tregojnë komunat kanë zgjeruar investimet në paisjen e shkollave me masa të efijencës, ku 62.95% e shkollave vlerësohen të jenë të pajisura me masa tilla, krahas 50.81% sa ishte në vitin 2020. Prej numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në komunë, sipas niveleve ISCEC 02, 1, 2, dhe 3, përqindja e atyre që janë të pajisur me licencë sipas UA 05/2017 MASHT, është 82.18% (sipas të dhënave të 24 komunave). Konstantja e llogaritur prej 26 nxënës për 1 mësimitdhënës sipas udhëzimit administrative të MASHT, është 67.46%. Lidhur me plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt, sipas të dhënave valide të 24 komunave, performance është 94.43% në raport me planifikimin. Mesatarja e kalueshmërisë (Kl.12) për komunat që kanë ofruar të dhëna valide, është 76.34%.

Në fushën e *shëndetësisë primare* janë ofruar të dhëna për infrastrukturën dhe hapësirat e destinuar për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunat, në përgjithësi kjo fushë ka nivel prej 51.14 në vitin 2021, krahas performances prej 55.96% të një viti më parë.

Bazuar në të dhënat e ofruara, 44.85% e objekteve të kujdesit primar shëndetësor janë të pajisura me mjetet e kërkuara sipas udhëzimit administrativ të MSH-së për shërbimet laboratorike, për dallim nga viti paraprak sa ishte 41.78%. Në 24 komuna me të dhëna valide, niveli i pajtueshmërisë me raportin një specialist i mjekësisë familjare dhe 2 infermirerë për 2000 banorë sipas kriteve të caktuara nga MSH, është 73.93%. Për këtë sektor, komunat kanë ndarë nga buxheti i të hyrave vetanake rreth 8.69 % krahasuar me Grantin specifik për shëndetësi të alokuar nga buxheti i përgjithshëm, apo 3.64%

## Kapitulli II

### II. Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2020

#### 1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2021 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 37 komuna, megjithëse shkalla e pavlefshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës.

**Sqarim:** Në vijim të raportit, llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

#### Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 19 fushat e tjera, në vitin 2021 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 81.66%.

### Ofrimi I shërbimeve administrative




Fig81. Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Gjatë vitit 2021 komunave u janë parashtruar 2,055.349 kërkesa për shqyrtim, nga të cilat janë shqyrtuar 1,950.299 kërkesa. Mesatarja e trajtimit të kërkesave për komunë është 25,710 kërkesa. Këtu përfshihen kërkesat për leje të ndryshme komunale, dokumentet e gjendjes civile, kërkesat për qasje në informata, kërkesat qytetare për financim dhe adresim në organet përgjegjëse të komunës.

Referuar performancës sipas komunave në këtë fushë, përqindja më e lartë në përbushjen e treguesve është në Komunën e Suharekës me 99.59%, kurse më e ulëta në Komunën e Gracanicës 33.33%. Për këtë fushë nuk kanë ofruar të dhëna komunat: Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Kllokot Shtërpçë, Zveçan, Leposaviç, për çfarë performanca i’u është llogaritur në 0% dhe që reflekton edhe në mesataren e përgjithshme për fushë.

### Shërbimet Publike Administrative





Fig 9 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

## Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kriterëve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.

Performanca e përgjithshme e arritur në është 66.92%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 77.62%. Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në lejin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 99.61%.




*Figure 10 Treguesit e performancës në fushën e transparencës*

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 45.95%, gjë që ndikon edhe në uljen e përgjithshme të performancës në këtë fushë. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përbushur në masën 85.83%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 86.98%. Të dhënat tregojnë për trend pozitiv në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 84.04%

Po ashtu, komunat kryesisht kanë qenë efikase në publikimin e buxhetit të komunës si dhe raporteve të shpenzimeve, në nivelin prej 74.81%. Sa i përket publikimit të planit vjetor të

## Transparenca Komunale Komuna



prokurimit publik dhe publikimit të kontratave komunat kanë përqindjen prej 82.13%

Figure 21 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës

Figura e mësipërme tregon për 6 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 90-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Lipjan (100.00%), Glogoc (100.00%), Suharekë (98.95%), Rahovec (93.87%), Shtime (93.22) Gjakovë (92.00), etj.

### Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale është inkuadruar si fushë e re në SMPK-së dhe ka gjithsej 22 tregues, prej të cilëve 17 janë aplikuar në vitin 2021. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 53.97%. Në kuadër të kësaj fushe, vërejmë performancë të lartë të komunave në ndërmarrjen e veprimeve ligjore për suspendimin e zyrtarëve për të cilët ka pasur aktakuzë në lidhje me veprat për shpërdorim detyrës zyrtare. Komunitat kanë treguar performancë pozitive edhe në diskutimin e projektbuxheteve dhe kornizës afatmesme të shpenzimeve. Sipas të dhënave në 36 komuna janë mbajtur 280 takime me qytetarë për projektbuxhetin, apo mesatarisht 8 takime për komunë. Në vijim është paraqitur lista e treguesve në këtë fushë sipas përqindjes:




Figure 12. Treguesit e performancës në fushën e përgjegjshmërisë komunale

Nga të dhënat e figurës së mësipërme del që pjesa më e madhe komunave nuk e kanë hartuar dhe si rrjedhojë nuk e kanë parashtruar në kuvend komunal planin vjetor të integritetit, që ka përqindje të ulët prej 5.41 %. Pavarësisht obligimit juridik të komunave për diskutimin e raportit të performancës për vitin paraprak në kuvendin e komunës, ky tregues është i ngrirë për shkak të Covid-19. Ndërsa, mbetet në nivel të ulët zbatimi i dispozitës së udhëzimit administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal për të publikuar raportet me rezultatet e proceseve të konsultimeve publike, prej 4.65%. Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2021, mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili është përmbushur në shkallën 21.91% krahasuar me vitin paraprak që ishte 16.45%. Te ky tregues vërehet një ngritje e lehtë në vitin 2021. Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 81.63% ,që krahasuar me vitin paraprak ka një rënie prej 7%,ku në vitin 2020 ishte 88.06%. Treguesi i për nivelin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 47.25%.

### Përgjegjshmëria komunale




Figure 13 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Performancën më të lartë në indikatorët e kësaj fushe e ka arritur komuna e Lipjanit (84.63%), Pejë (80.71%), Rahovec (75.69%) dhe Glllogoc (73.64%). Ndryshe nga to, më ulët qëndrojnë komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Shtërpça, Partesh, Leposaviq. Në nivelin të performancës në këtë fushë, ka ndikuar edhe mos raportimi i të gjitha të dhënave për tregues nga komunat në fjalë.

### Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 55.09%.




Figure 14 Treguesit e performancës në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe: Përqindje me e lartë është shënuar në dy tregues, Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, ne masën 47.92% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 60.86%




Figure 15 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

### Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive.

Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 74.81%.




Figure 16. Treguesit e performancës në fushën e kulturës

Në figurën e mësipërme janë prezantuar dy tregues të fushës numër 5- Kulturë, Rini dhe Sport. Treguesit, Aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes është 62.72%, kurse Hapësira për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banoreve në komuna është 58.60%.

Të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe janë si vijon:




Figure 17 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e kulturës

### Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 61.67%.




Figure 183 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të fatkeqësive

Sipas të dhënave, intervenimet e institucioneve komunale ndaj fatkeqësive del të jenë në nivel prej 75.35%. Shprehur në numër, në 33 komuna që kanë raportuar për këtë tregues, nga 10661 fatkeqësi të raportuara ekipet përgjegjëse komunale kanë intervenuar në 10307 prej tyre. Niveli i realizimit të treguesve për këtë fushë është si vijon: Intervenimet e për mbrojtje nga fatkeqësitë ka përqindjen 75.35%, ndërsa në nivel të ulët të realizimit mbetet treguesi për realizimin e planit komunal për menaxhimin fatkeqësive prej 17.82%




Figure 19. Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe të tjera

### Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 50.35%.




Figure 20. Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor

Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 6.88%. Sa i përket lejeve ndërtimore, nga 1811 kërkesa të parashtruara për leje ndërtimi, nga komunat u shqyrtuan me kohë 71.17%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimore, u inspektuan në shkallë prej 57.61%. Nga totali i objekteve të reja të inspektuara, 67.44% janë raportuar të pajisura me leje ndërtimore.




Figure 21 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

### Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 50.35%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.




Figure 22. Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përmbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.

Sipas të dhënave rreth 46.02% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 62.50% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik.




Figure 23 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

### Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës

rrugore me trotuare, ndriçim, shenjzim si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 52.04%.




Figure 24 Treguesit e performancës në fushën infrastrukturës rrugore

Ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja treguesit i ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Nivelin e përmbushje së treguesve të kësaj fushe e kemi në tabelën më lart. Vlen të përmendet treguesi me nivelin me të ulët, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 6.58% dhe treguesi me përmbushjen më të lartë prej 44.45% gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjzim vertikal dhe horizontal.

Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:




Figure 25 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

## Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 56.64 %.



Figure 26. Treguesit e performancës në fushën e transportit publik

Në kuadër të kësaj fushe vërejmë performancë mbi mesatare për dy tregues. Sipas të dhënave, nga totali prej 1261 vendbanimeve të 34 komunave që kanë raportuar, 1048 e tyre janë të përfshira në transport publik lokal, kurse vendndalimet e shënjizuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 52.92%. Në nivel të ulët është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 13.53%

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 27 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik

### Fusha 11 – Parkingjet Publike

Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtuara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për më tepër, kjo fushë matë numrin e parkingjeve në komunë dhe numrin e vendparkimeve kundrejt veturave të regjistruara në komunë, po ashtu sa ka vende për taksit kundrejt numrit të taksive të licencuara dhe sa parkingje publike kanë vende të rezervuara për persona me nevojë të veçanta. Performanca në nivel të fushës është 47.04%.




Figure 28 Treguesit e performancës në fushën e parkingjeve

Krahasuar me numrin e automjeteve të regjistruara, komunat me vendparkime mbulojnë 9.99%. Shkalla e vendparkimeve të destinuar për makinat taksit të regjistruara në komuna është 50.09%. Sa i përket numrit të vendparkimeve për persona me aftësi të kufizuara, vetëm 46.71% e parkingjeve i kanë të shënuara vendet e tillë. Ndërsa numri i parkingjeve publike për parkimin e mjeteve motorike është 27.40%

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.




Figure 29 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e parkingjeve publike

## Fusha 12 - Uji i pijshëm

Kjo fushë matë sigurimin apo furnizimin e qytetarëve dhe bizneseve me ujë të pijshëm si dhe realizimin e projekteve komunale për ujë të pijshëm. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 67.35% në krahasim me vitin 2020 sa ishte 80.07%.




Figure 30 Treguesit e performancës në fushën e ujit të pijshëm në nivel vendi

Sa i përket ekonomive familjare, institucioneve publike dhe njërive biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm, ky tregues në përqindje është përmbushur prej 64.21 %. Ndërsa Plani për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në përqindje është realizuar 48.65%

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figura 31 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e ujit të pijshëm

Sipas figurës së mësipërme, vërejmë se 3 komuna kanë raportuar për shtrirje të rrjetit të ujit të pijshëm në 100% te ekonomitë familjare, institucionet publike dhe ekonomitë biznesore, kurse 6 komuna nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme.

### Fusha 13 - Kanalizimi

Kjo fushë matë përfshirjen e ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve në sistemin e kanalizimit si dhe realizimin e projekteve komunale për rrjet të kanalizimit. Po ashtu, ky tregues matë edhe përfshirjen e vendbanimeve të komunës në rrjetin për trajtimin e ujërave të zeza si një nga faktorët mjaft të rëndësishëm në ambient, kushte të jetesës dhe shëndetin publik. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 35.49%, për dallim nga viti 2020 sa ishte 40.18%.





Figure 32 Treguesit e performancës në fushën e kanalizimit

Sipas të dhënave rreth 53.44% të ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë deklaruar të përfshira në sistemin e kanalizimit, për dallim nga 74.19% sa ishte në vitin 2020. Në anën tjetër, zbatimi i aktiviteteve nga plani për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit të kanalizimit është raportuar të jetë 60.10% për dallim nga 86.54% sa ishte në vitin 2020. Për treguesin e trajtimit të ujërave të zeza, për shkak të pezullimit të treguesit, është aplikuar vlera 0% për të gjitha komunat me qëllim të pasqyrimin të drejtë të rezultateve në fushë.



\* Tek % totale ka ndikuar shkalla e ulët e trajtimit të ujërave të zeza. Kjo fushë është mjaft specifike dhe arritjet e plota mund të konsiderohen vetëm në rastet kur menaxhimi i ujërave të zeza përcjellët me trajtimin e tyre përmes impianteve. Në vitin 2019, kjo fushë ishte shpallur e pavlefshme, për shkak se nuk janë ofruar të dhëna të sakta, duke bërë që të dhënat të konsiderohen nule. Edhe në ato komuna ku ishte raportuar për venien në funksion të sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza apo impianteve, të dhënat nuk ishin raportuar të plota në lidhje me numrin e vendbanimeve të përfshira në sistemet e impianteve.

Figure 33 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e kanalizimit

### Fusha 14 – Menaxhimi i Mbeturinave

Kjo fushë matë mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave në komunë si dhe grumbullimin e të hyrave nga faturat e lëshuara për menaxhimin e mbeturinave. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 70.15%.




Figure 344 Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave

Të dhënat e raportuara të vitit 2021 nga komunat tregojnë se ekonomitë familjare me qasje në grumbullim të mbeturinave janë në shkallën prej 67.26%. Shkalla e inkasimit të mjeteve për grumbullimin e mbeturinave del të jetë në masën 72.89%. Ndërsa, realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave është 72.40%, sikurse Sasia e deponimit te mbeturinave ne kilogram për koke banori është 50.60%. kurse realizimi i i planit komunal pe menaxhimin e mbeturinave është përmbushur 40%.




Figure 35 Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën menaxhimit të mbeturinave

## Fusha 15 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 63.61%.




Figure 36 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Realizimi i planit të veprimit të mjedis del të jetë arritur në masën prej 13.87%<sup>7</sup>. Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 64.74% ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë mjaftë të ulët prej 55.48%.




Figure 37 Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

## Fusha 16 – Përfaqësimi Gjinator

Përfaqësimi gjinator matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktivitetet komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale, trupat e kuvendeve

<sup>7</sup> Shumica e komunave nuk kanë dëshmuar ta kenë të hartuar Planin Lokal për mbrojtje të Mjedisit

komunale etj. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar minimizojnë përqindjen në këtë fushë duke e bërë atë mjaft të ulët, 38.02%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinor sipas treguesve:




Figure 37 % e treguesve në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor<sup>8</sup>

Sipas të dhënave të raportuara nga 37 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 73.57% në raport me kriterin 50x50<sup>9</sup>. Po ashtu, 51.35% e komunave dokumentuan të hartuar planin për barazi gjinore. Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 44.53% e kriterit ligjor. Përqindja e përfaqësimit në trupat e kuvendeve komunale është 6.66% e kriterit 50x50. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 43.60% të përmbushjes së kriterit ligjor.

Përfaqësimi gjinor tek emrat e rrugëve komunale është tejet i ulët, shprehur në 11.38% po ashtu edhe regjistrimi i pronave në emër të një grua apo dy gjinive (bashkëshortë apo vëllezër dhe motra), është mjaftë e ulët, 7.40%.

Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor ka vlerën 39.19%. Me që ky tregues ka vlerë të ulët të përkrahjes nga komunat, megjithatë, ka nevojë mjaft të madhe për trajnim në këtë

<sup>8</sup> Niveli 50% konsiderohet arritje e plotë e përfaqësimit duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore

<sup>9</sup> Nuk kanë ofruar të dhëna komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Shtërpcë, Novobërdë, Kllokot

drejtim si dhe për vullnet të komunave që të kuptojnë rëndësinë e kësaj çështje. Barazia gjinore në programet për punësim, subvencione dhe ndërmarrësi është në shkallë prej 60.74%.

### Përfaqësimi gjinor




Figure 38 Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

### Fusha 17 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësimitdhënësve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 58.39%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.




Figure 39 % e treguesve në fushën e arsimit parauniversitar në nivel vendi

Fusha e arsimit ka me shume tregues por në grafikun me lart do ti paraqesim disa nga treguesit sipas përqindjes. Treguesi, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 99.14%, sikurse edhe shkalla bruto e regjistrimit ne klasën e parë është përbushur 96.69%. Ndersa shkalla e realizimit te orëve te planifikuara sipas kalendarit vjetor te arsimit është përbushur 96.22% dhe shkalla e qasjes se tranzicionit. Kalueshmëria ne testin e maturës kombëtare ka vlerën 76.34%, Kurse mësimdhënësit qe i plotësojnë kriteret dhe kane kualifikim te licensuar shprehur ne përqindje janë 82.18%. Sa i përket procedurave ligjore pe zgjedhjen e stafit drejtues ne shkolla 9 drejtoreve dhe zv. drejtoreve) përbushja e kriterit ligjore është përbushur 87.68%, si dhe plotësimi i vendeve te lira te punës në arsim me konkurs të rregullt, është përbushur 92.43%.

### Arsimi Parauniversitar




Figure 40 Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

### Fusha 18 – Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuar për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 51.14%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:




Figure 41 % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Treguesit nga kjo fushe janë shumë numër, por ne do ti prezantojmë ne paraqitje grafike disa nga këta tregues, sepse janë mjaft specifik dhe me shume interes për komunat. Treguesi, fëmijë të përfshirë në programin e imunizimit është përmbushur 91.40%, kjo është një

përqindje e kënaqeshe, por duhet të shkojë në tendencë të rritjes në vitet e ardhshme. Sikurse ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur 87.50%. Ndërsa tregues që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të kushteve infrastrukturore janë si vijon: Objekte të KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike janë përmbushur 44.85%, ndërsa m<sup>2</sup> hapësirave të KPS për 1000 banorë, ka vlerën prej 66.14%. Kurse niveli i pajtueshmërisë me raportin një mjek familjar edhe dy infermier për 2000 banorë, në nivel të komunave është arritur 41.96 %.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:




Figure 42 Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

### Fusha 19 – Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë matë aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit të tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 44.55%.




Figure 43 e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues në grafikun me lartë. Plani për zhvillim ekonomik lokal është përbushur nga komunat 28.38%. Kurse niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë pa borxhe interes dhe ndëshkime është përbushur në 41.09%. Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale në shfrytëzim është përbushur në 43.24%. Kurse niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë është përbushur në 50.66%.

### Zhvillimi ekonomik lokal




Figure 44 Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

## Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2021 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2021 është bërë për 37 komuna<sup>10</sup>. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale. Komuna e Skenderajt nuk ka raportuar për vitin 2021.
2. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë
3. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
4. Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Transparenca komunale renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. Vetëm 4 komuna kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve (Mitrovica e Jugut, Podujeva, Rahoveci dhe Kaçaniku). Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politik bërja dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
5. Prezenca e qytetarëve në konsultimet publikë ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrësit.
6. Komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok nuk përdorin ueb-faqet zyrtare të tyre. Asnjë informatë, raport apo dokument zyrtar nuk është

---

<sup>10</sup> Komuna e Skenderajt nuk ka raportuar për 2021

- publikuar në ueb-faqet e tyre. Komuna të tjera, si Deçani, Shtërpca, Fushë Kosova, Juniku, Obiliqi, Parteshi, Podujeva dhe Raniillugu, duhet të përshtatin dhe plotësojnë informacionet pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me akte nënligjore. Për më tepër informatat duhet vendosur në meny të përshtatshme, për ta bërë më të lehtë qasjen në to. Publikimi i dokumenteve duhet të bëhet sipas menyve (aplikacioneve) specifike për materiale të caktuara.
7. Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor. Komunat duhet të ndërmarrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.
  8. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, performanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.
  9. Vetëm 5.40% e komunave kanë dëshmuar ta kenë diskutuar në Kuvendin e Komunës planin e integritetit, 20.69% raportin e auditorit të brendshëm dhe 23.68% Raportin e performancës komunale për vitin paraprak. Këto plane dhe raporte duhet të bëhen pika diskutimi të rregullta për çdo vit në kuvendet komunale me qëllim që të forcohet niveli i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit dhe qytetarëve.
  10. Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e punësimit. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
  11. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;
  12. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotuaret, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçiklistëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.
  13. 4.62% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë që tregon se komunat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.

14. Edhe pse në treguesi për trajtimin e ujërave të zeza nuk është matur në vitin 2020, të dhënat e vitit 2021 tregojnë se duhet të sigurohet koordinim ndërinstitucional për të siguruar trajtim të ujërave të zeza paralelisht me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit. Trajtimi i ujërave të zeza është i shprehur në masë tejte të ulët, marrë parasysh koston e lartë të këtij shërbimi. Komunitat duhet të shqyrtojnë edhe mundësitë e burimeve të tjera financiare për krijimin e impianteve, në mënyrë që të evitohen shumë probleme mjedisore dhe të mbrohet shëndeti publik.
15. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunitat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kriterëve ligjorë. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohej promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunitat duhet të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
16. Komunitat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
17. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë efikente, si dhe të jenë të pajisura me kabinate me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimin gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.
18. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunitat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që të aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

Shërbimet Publike Administrative	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit Administrativimi zaktevi koji su razmatrani tokom godine	94,35
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	99,97
	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	74,63
	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	45,95
Transparenca Komunale	2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët	96,61
	2.1.3	Përmblushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës Përmblushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	85,83
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës	86,98
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	84,04
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzime të buxhetit Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzime të buxhetit	74,81
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	82,13
	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	68,06
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	21,91
	3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	63,45
	3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	87,10
Përgjegjshmëria Komunale	3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	4,65
	3.1.6	Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit Local councils that have held at least 6 meetings a year	37,58
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	83,46
	3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	62,50
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	85,42
	3.2.5	Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Kuvendin Komunal Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Kuvendin Komunal	16,22
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me plesëmarrje të kryetarit të komunës Mbledhje të Kuvendit me plesëmarrje të kryetarit të komunës	72,74

	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	81,63
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Auditimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit	47,25
	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	5,41
	3.4.2	Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	93,79
	3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbuesit civil Kontratrat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore	79,16
	3.5.3	Kontratrat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	51,35
	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	33,67
Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	58,13
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social	47,92
	4.2.2	Fëmijë me nevojë të cilave iu është siguruar strehimi familjar	60,86
Kulturë, Rini dhe Sport	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	58,60
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	62,72
Menaxhimi i fatkeqësive	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	17,82
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë	75,53
Planifikimi Hapësinor	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësisht)	6,88
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit	71,17
	7.2.2	Ndërtesa të reja të inspektuara	57,61
	7.2.3	Objekte të reja të inspektuara	67,44
Hapësirat Publike	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m <sup>2</sup> për kokë banori	13,96
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	46,02
Infrastruktura Rrugore	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	62,50
	9.1.1	Rrugët lokale të shtriuara	64,10
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	42,30

9.1.3	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	47,81
9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	21,43
9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	33,81
9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	44,45
9.2.4	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	6,58
9.2.5	Rrugët lokale të riasfaltuara Rrugët lokale të riasfaltuara	50,37
10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	10,83
10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	57,55
10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	52,92
11.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	24,70
11.1.2	Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	9,99
11.1.3	Vendparkimet e destinuar për taksi Vendparkimet e destinuar për taksi	50,09
11.1.4	Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara	46,71
12.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit implementation of the plan for construction and maintenance of the water supply system	48,65
12.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm Household, public institutions and business units involved in the drinking water system	64,21
13.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	60,10
13.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	53,44
14.1.1	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	40,00
14.1.2	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	67,26
14.2.1	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	72,40
14.2.2	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	72,89
14.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	50,62
15.1.1	Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis	13,87
15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara Lejet mjedisore komunale të lëshuara	64,74

	15.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisorë komunale	55,48
	16.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	73,57
	16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	43,60
	16.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	44,53
	16.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteteve komunale Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteteve komunale	50,48
	16.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	6,66
	16.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjeshëm gjinor Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjeshëm gjinor	39,19
	16.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	60,74
	16.2.3	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike Pjesëmarrja e grave në takime publike	29,01
	16.2.4	Plani komunal për barazi gjinore Plani komunal për barazi gjinore	51,35
	16.3.1	Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	11,38
	16.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	7,40
	17.1.1	Çerdhe dhe kopshte publike në zona rurale për 10000 banorë Çerdhe dhe kopshte publike në zona rurale për 10000 banorë	0,52
	17.1.2	m2 të hapësirave shkollore për kokë nxënësi – urban dhe rural m2 të hapësirave për nxënësi – urban dhe rural	54,79
	17.1.3	Shkollat e pajisura me kabinet të TIK (Teknologji Informative dhe Komputerike) Shkollat e pajisura me kabinet të TIK	71,34
	17.1.4	Shkollat me masa të eficientës së energjisë Shkollat me masa të eficientës së energjisë	62,95
	17.1.5	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	73,19
	17.1.6	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar Kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	65,77
	17.2.1	Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licencuar Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licencuar	82,18
	17.2.2	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënësi për mësimdhënësi - urban dhe rural Niveli i pajtueshmërisë me raportin nxënësi për mësimdhënësi - urban dhe rural	67,46
	17.2.3	Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	3,60
	17.2.4	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt	92,43
	17.2.5	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues	93,15
	17.2.6	Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve) Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve)	87,68

**Përfaqësimi Gjinor**

**Arsimi Parauniversitar**

	17.3.2	Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1 Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1	96,69
	17.3.3	Shkalla e qasjes – tranzicioni K9- K10 Shkalla e qasjes – tranzicioni K9- K10	92,57
	17.3.4	Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta	58,02
	17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë) Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)	76,34
	17.3.7	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse) Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	99,14
	17.3.8	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vijtor të arsimit Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vijtor të arsimit	96,22
	18.1.1	m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë	66,14
	18.1.2	Objektet e KPS që janë të paisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	44,85
	18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	41,96
	18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	8,69
	18.3.1	Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori	35,83
	18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	91,40
	18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra dhe femijë Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe femijë	72,73
	19.1.1	Plani për zhvillim ekonomik lokal Plani për zhvillim ekonomik lokal	28,38
	19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim	94,12
	19.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në pronë	72,09
	19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	41,09

### Kujdesi Primar Shëndetësor

### Zhvillimi Ekonomik Lokal



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		10/01 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02-	052/01	1966	

Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit



**Kuvendi  
Komiteti për Komunitete**

**PROPOZIM**

**Raporti për vitin 2022**

**Hyrje**

Komiteti për Komunitete, në vitin 2022, punët dhe aktivitetet i ka fokusuar në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi mbi bazen e dispozitave ligjore, punëve dhe aktiviteteteve të përcaktuara në planin e punës.

**Puna dhe aktivitetet**

*Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 6 mbledhje të rregullta, dhe janë shqyrtuar disa çështje. Në fillim të muajit Shkurt 2022 është zgjedhur Kryesuesi i këtij Komiteti si dhe është miratuar Plani i Punës për vitin 2022.*

*Në mbledhjen e mbajtur në muajin Prill, për punën dhe aktivitetet ka raportuar përfaqësuesja e Zyres për Komunitete dhe Kthim znj. Afije Veseli.*

*Në mbledhjen e mbajtur në muajin Maj, lidhur me temën "Diskutim për qent endacak" e ftuar ka qenë Drejtoresha e Shërbimeve Publike znj. Lumnije Krapit, e cila ka folur për punën e Komunës së Drenasit për trajtimin e qenve endacak.*

*Në mbledhjen e mbajtur në muajin Korrik, për temën "Raportim nga Handikos" i ftuar ka qenë përfaqësuesi i Handikos në Drenas z. Bexhet Binaku, i cili ka folur për punën e kësaj organizate në komunën e Drenasit.*

*Në mbledhjen e mbajtur në muajin Shtator, temë diskutimi ishte "Tetori-Muaji ndërkombëtar i kancerit të gjirit", për të diskutuar për këtë temë i ftuar ishte Drejtori i Shendetësisë në komunën e Drenasit z.Arsim Haxhiu.*

*Në mbledhjen e fundit që u mbajt në muajin Dhjetor, temë diskutimi ishte "Raportim nga Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave", për punën dhe aktivitetet e kësaj qendre foli znj.Eronita Brahim.*

*Drenas, Janar 2023*

*Kryesuesi i Komitetit*

*Drin Halilaj*



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		10.01.2023	
Nj. Org.	Numër	Struja	Vlera
02	052/01-1707		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Gllogocit (Drenasit)  
Kuvendi Komunal



KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË  
KOMUNËN E DRENASIT

Publikon:

**RAPORTIN VJETOR**

Për periudhën:

Janar-Dhjetor 2022

Drenas, 2022

## PËRMBAJTJA

<b>I PJESA HYRËSE</b> .....	4
Prioritetet përgjatë vitit 2022.....	5
<b>II PJESA TEMATIKE</b> .....	7
Mbledhjet e Realizuara & Aktivitete të rëndësishme.....	7
Mbledhja e parë.....	8
Mbledhja e dytë.....	16
Mbledhja e tretë.....	12
Mbledhja e katërt.....	15
Mbledhja e pestë.....	17
Mbledhja e gjashtë.....	19
<b>III PJESA PËRMBYLLËSE</b> .....	21
Konkluzione & Rekomandime.....	21
Objektivat e arritura & Rezultatet.....	21
Kufizime.....	23
Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2023.....	23
Planet prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2023.....	24
Foto nga aktivitetet e Realizuara.....	25

## **SHKURTESAT**

**FNV**- Fëmijë me nevoja të veçanta

**UA**- Udhëzim Administrativ

**QPS** -- Qendra për Punë Sociale

**ZP** – Zyra e Punësimit

**KKPAK** - Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

**PAK** - Persona me Aftësi të Kufizuara

**AK** – Aftësi e Kufizuar

**OJQ** - Organizata Jo Qeveritare

(I)

**PJESA HYRËSE**

**PARATHËNIE**

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, publikon këtë raport vjetor, me qëllim që të mbajë të informuar qytetarët e komunës së Drenasit, veçmas komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuara lidhur me punën, aktivitetet e realizuara, dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2022.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), si organ drejtues i ri institucional, është formuar për herë të parë në komunën e Drenasit në vitin 2019, dhe si i tillë, vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komitetetve të Përhershme dhe Komiteteve të tjera në Komuna”. Përmes mbledhjeve të realizuara, anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK kanë shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e veta, dhe kanë vënë disa prioritetet. Specifikisht, si qëllim prioritar i këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t’i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kjo gjithnjë në bashkëpunim të përhershëm me vet këta persona, me institucionet komunale, me OJQ-të që ofrojnë shërbime psiko-sociale, e veçmas me ato OJQ që ofrojnë shërbime me përfshirje të PAK.

Si çdo vit, për t’i arritur objektivat e synuara, Komiteti Konsultativ për PAK me fillim vit ka hartuar planin e punës dhe kalendarin për takime për vitin 2022, në bazë të të cilit dhe ka realizuar aktivitetet.

Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, por jo vetëm. Përveq mbledhjeve të rregullta, ky komitet ka mbajtur rreth 25 takime të tjera konsultative dhe vizita në terren përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të jetës së personave me aftësi të kufizuara- në komunën e Drenasit. Mbledhjet formale, zakonisht ky komitet i ka mbajtur në zyrën II me xhama pranë byfësë në Komunën e Drenasit, tryezat e rrumbullakëta në zyrën e bordit, kurse takimet tjera konsultative i ka zhvilluar në terren dhe sipas rastit. Ftesa për mbledhje u është dërguar anëtarëve dhe të ftuarve të tjerë 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Andaj, krahas asaj çfarë është paraparë në planin e punës, ky komitet ka identifikuar një sërë nevojash për ndryshim në të mirën e PAK. Nevoja për këto ndryshime, është identifikuar përmes takimeve me vet PAK dhe familjarë të tyre, me zyrtarë, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të OJQ-ve, përmes hulumtimeve të realizuara, dhe të tjera aktiviteteve, ku dhe kemi arritur të nxjerrim disa rezultate të cilat më pas janë ngritur në formën e rekomandimeve (propozimeve për ndryshim) dhe janë diskutuar me digaster të ndryshëm. Pas diskutimit, bashkërisht jemi dakorduar që këto rekomandime të shërbejnë si përpjekje për ndryshim në vitet vijuese.

## **Prioritetet përgjatë vitit 2022**

Disa ndër objektivat më të rëndësishme që kanë rrjedhur nga Plani Vjetor i Punës janë:

- ◆ Identifikimi i sfidave të Institucioneve në Komunën e Drenasit, që trajtojnë aspektin e aftësisë së kufizuar, qoftë aspektin mendor, fizik, intelektual apo shqisor afat-gjatë të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët, dhe bashkërisht të hartojmë një plan specifik për të tjetkaluar këto sfida.
  - ◆ Realizimi i aktiviteteve të ndryshme lidhur me ndërgjegjësimin e shoqërisë krahas stigmës dhe paragjyqimeve që janë krijuar ndaj PAK.
  - ◆ Realizimi i aktiviteteve të ndryshme për shënimin e datave të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.
  - ◆ Mbajtja e takimeve publike me qytetarët me qëllim të marrjes së pikëpamjeve, kërkesave, propozimeve dhe kritikave, në mënyrë që bashkërisht të mund t'i kontribuojmë fushës së AK, mbrenda kompetencave që na lejon UA në harmoni me të cilin veprojmë.
  - ◆ Rritja e burimeve të informacionit për PAK lidhur me adresimin e nevojave të tyre drejtuar KKPAAK.
  - ◆ Bashkëpunimi me OJQ-të që përfaqësojnë persona me aftësi të kufizuara, për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre, në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes.
  - ◆ Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me homologë/ anëtarë të Komitetetve Konsultative për PAK nga komunat e tjera, me qëllim të informimit për përvojat pozitive në kuadrin ligjor, në zbatueshmërinë e tij, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar në këto komuna, si dhe me pjesëmarrjen aktive të këtij komuniteti në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.
  - ◆ Ngritja e rekomandimeve kryesisht që kanë të bëjnë me investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës (rregullimin e pjerrinave, trotuareve etj).
- Bashkëpunimi me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe me kohë në shtëpi, për PAK.
- ◆ Realizimi i intervistave dhe/apo hulumtimeve në terren, mbi bazën e identifikimit të aspekteve prioritare që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, dhe ngritja e rekomandimeve praktike mbi bazën e rezultateve.
  - ◆ Hartimi i broshurave mbi ndërgjegjësimin e shkollave, institucioneve komunale, dhe shoqërisë në përgjithësi, mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

- ◆ Identifikimi e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në aktivitetet, kurset dhe trajnimet në Akadaminë “Flutura”, në Drenas, kjo si rezultat i rekomandimeve të dhëna nga KKPAK, vitin e kaluar.
- ◆ Bashkëpunimi me Qendrën për Punë Sociale për të identifikuar numrin e fëmijëve me AK, familjet e të cilëve kanë parashtruar kërkesa mbi njohjen e të drejtës për pension.
- ◆ Bashkëpunimi me Zyrën e Pensioneve për të identifikuar numrin e personave mbi moshën 18 vjeç të cilët kanë parashtruar kërkesa për të siguruar të drejtën për pension, përkitazi me kategorinë që përcakton plotësimin e kriterëve.
- ◆ Bashkëpunimi me Zyrën e Punësimit për të siguruar të dhëna lidhur me numrin e punëkërkuesve dhe të papunëve të regjistruar në vitin/vitet e fundit në këtë zyrë.

(II)

**PJESA TEMATIKE**

**MBLEDHJET E REALIZUARA & AKTIVITETE TË RËNDËSISHME**

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta, në periudhën Janar - Dhjetor 2022. Të gjitha mbledhjet janë realizuar në kohën e paraparë me Planin e Punës, si dhe sa i përket aktiviteteve ato janë realizuar me kohë dhe rezultatet e arritura kalojnë pritjet e planit të punës. Si çdo vit, burimet e raportit vjetor të aktiviteteve të realizuara edhe për vitin 2022 janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të komitetit. Ky raport vjetor, pas miratimit nga anëtarët e komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Drenasit.

Mbledhjet në vazhdim paraqesin të dhëna lidhur me:

- Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjeve
- Të ftuarit
- Pikat e rendit të ditës
- Konkludimet e nxjerra në secilën mbledhje si dhe
- Rekomandimet

## Mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 04.02.2022

Me datën 04.02.2022 (E premte), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e parë, të rregulltë, në zyrën e bordit të Komunës së Drenasit.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti:

1. Shemsi Bërbatovci – Kryesues i KKPAK
2. Ariana Isufi – Zëvendës kryesues
3. Arlindë Krasniqi - Anëtare
4. Jehona Abdyli – Anëtare
5. Burim Fazliu – Anëtar

Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi.



**Pikat e rendit të Ditës ishin:**

1. Raporti vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021
2. Miratimi i Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për PAK, për vitin 2022
3. Koordinimi lidhur me riadresimin e disa rekomandimeve, nga raporti vjetor 2021 tek institucionet përkatëse
4. Të ndryshme

- Bazuar në rendin e ditës, fillimisht kemi diskutuar lidhur me Reportin Vjetor të Punës për vitin 2021, se çfarë është realizuar, sfidat dhe çfarë ka rekomanduar ky raport përmbledhës i punës një vjeçare për vitin e ardhshëm.
- Pastaj për diskutim kemi kaluar tek pika e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e planit të punës për vitin 2022, ku kemi radhitur bashkërisht shumë nga prioritetet me rëndësi.
- Lidhur me pikën e tretë, jemi dakorduar dhe koordinuar që bashkërisht do të marrim iniciativë të riadresojmë disa nga rekomandimet drejtuar drejtorive apo institucioneve përkatëse, por të cilat nuk kanë vepruar së zbatuari këto rekomandime gjatë vitit të kaluar.
- Kurse sa i përket pikës së katërt, përkatësisht tek të ndryshme, kemi diskutuar lidhur me evidentimin e avancimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara (aftësi të kufizuara) në shkolla dhe kopshte, pas sistemimit të asistentëve për këta fëmijë në fillim të vitit 2022, si dhe të krahasojmë këtë nivel avancimi para dhe pas, në mënyrë që të vazhdojmë me rekomandime për sistemimin e këtyre asistentëve në të gjitha shkollat nëse është e mundur, brenda një kohe të shkurtër.

Meqenëse nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, me kaq mbledhja e parë e KKPAK përfundoi, duke shpresuar në realizimin e aktiviteteve për mbledhjet dhe takimet e ardhshme. Mbledhja u mbyllë nga procesmbajtësi - Ariana Isufi, në orën 12:00.

## Mbledhja e dytë e Komitetit Konsultaiv për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 06.04.2022

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, me datë: 06.04.2022, ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë. Vend takim për këtë mbledhje kishim zyrën me xhama në komunë.

Mbledhja filloi nga ora 13:00, dhe të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e KKPAK-së, përkatësisht:

Ariana Isufi

Burim Fazliu

Arlindë Krasniqi

Jehona Abdyli

Shemsi Bërbatovci.



#### Pikat e rendit të Ditës ishin:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.02.2022
2. Propozim bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve stomatologjike apo dentare, për kontrolla sistematike për PAK

3. Shqyrtimi i mundësive për të realizuar projekt në shkolla, lidhur me ndërgjegjësimin e nxënësve për PAK
4. Planifikimi për takim dhe koordinim të aktiviteteve me asistentët mbështetës në komunën e Drenasit
5. Planifikimi për hartimin e një broshure për nderë të muajit Prill, muajit të ndërgjegjësimit për personat me autizëm.
6. Të ndryshme

Bazuar në rendin e ditës, lidhur me pikën e parë, gjegjësisht miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, jemi dakorduar që gjatë vitit mund të ridizajnojmë planin vjetor të punës, të shtojmë apo edhe të modifikojmë aktivitete, varësisht nga rrethanat.

Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, Burim Fazliu ka propozuar si pikë bashkëpunimin e KKPAK me stomatologët që operojnë në komunën e Drenasit, në mënyrë që ata të ofrojnë kontrolla sistematike dhe falas për PAK. Kjo pikë apo ide ka gjetur përkrahjen e të gjithë anëtarëve të grupit.

Pikën e tretë, lidhur me shqyrtimin e mundësive për të realizuar projekt në shkolla, për ndërgjegjësimin e nxënësve për PAK, e ka parashtruar si ide, anëtarja Ariana Isufi, ku për të kuptuar më shumë rreth procedurave, në takim kemi ftuar edhe drejtorin e DKA-së z. Gjoka, i cili na është përgjigjur pozitivisht ftesës sonë për takim, dhe ka përkrahur idenë.

Lidhur me pikën e katërt përkatësisht, takimin e planifikuar me asistent mbështetës në komunën e Drenasit, si aktivitet e ka propozuar Arlinda Krasniqi, dhe më pas në diskutim janë involvuar edhe anëtarët e tjerë Shemsiu dhe Jehona, si dhe z. Gjoka, na ka rekomanduar t'i bashkangjitemi grupit të asistentëve mbështetës në aktivitetet e planifikuara me 14 prill, për nderë të muajit të ndërgjegjësimit të personave me autizëm.

Në pikën e pestë, kemi zgjedhur që këtij aktiviteti të planifikuar për organizim në muajin Prill-muajit të ndërgjegjësimit të personave me autizëm t'i bashkohemi me hartimin e një broshure fillimisht, por t'i kontribuojmë këtij procesi edhe në forma të tjera.

Meqenëse nuk kishte pika të tjera për diskutim, në orën 15:00, përfundam mbledhjen.

## Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultiv për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 27. 06. 2022

Komiteti Konsultiv për PAK, të hënën, gjegjësisht, me datë: 27.06.2022, mbanë mbledhjen e tretë të rregulltë me radhë, duke filluar nga ora 13:00, në zyrën me xhama. Kjo mbledhje është udhëhequr, nga zv. kryesuesja Ariana Isufi.

Pjesë e mbledhjes ishin katër nga pesë anëtarët e komitetit në fjalë, gjegjësisht:

Ariana Isufi  
Shemsi Bërbatovci  
Arlinda Krasniqi  
Jehona Abdyli

Për të diskutuar bashkë për aktivitetet, të arriturat dhe rezultatet në gjashtë mujorin e parë të këtijë viti, të ftuar kishim edhe Kryesuesin e Kuvendit Komunal, z. Milaim Hajdari.



**Pikat e rendit të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit, të datës: 06.04.2022
2. Realizimi i videove informuese-ndërgjegjësuere, lidhur me fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara
3. Takime me prindërit e fëmijëve/nxënësve me aftësi të kufizuara, mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit me OJQ, asistentë për FNV dhe mësuesit mbështetës në shkolla
4. Shqyrtimi i mundësive për kërkesat e asistentëve për transferimin e nxënësve me dëmtime të rënda (shumëfishta), nga klasat gjithëpërfshirëse, në Dhomën Burimore në Komoran – (aprovimi nga prindërit)
5. Sigurimi i transportit për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara
6. Të ndryshme

Bazuar në rendin e ditës, lidhur me pikën e parë, gjegjësisht miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, unanimisht jemi dakorduar që aktivitetet e planifikuara, vetëm se kanë përfunduar me sukses, përfshirë bashkëpunimin me Ordinancat Stomatologjike për ofrimin e shërbimeve dentare falas për FNV; mbajtjen e ligjeratave ndërgjegjësuere në shkolla, lidhur me diskriminimin, paragjykimet dhe etiketimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara; takimi me asistentët dhe mësuesit mbështetës në shkolla si dhe publikimi dhe shpërndarja e Broshurës, për nderë të muajit Prill-muajit të ndërgjegjësimit për fëmijët me autizëm.

Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, në mënyrë që t'i kontribuojmë fuqizimit të personave me aftësi të kufizuara, kemi planifikuar që secili anëtar i komitetit tonë, të zgjedhë nga një mesazh me zë dhe ta përçojmë me video, me qëllimin për tu siguruar personave me aftësi të kufizuara, gëzimin apo ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut njësoj si pjesa tjetër e popullësisë.

Në pikën e tretë, meqë nga takimi me asistentët për FNV në shkolla, kemi nxjerrur përfundime se prindërit nuk i përgjigjen ftesave që i bëhen nga mësuesit, për fëmijët e tyre, atëherë kemi rekomanduar takime me prindërit e këtyre fëmijëve/nxënësve, mbi nevojën e bashkëpunimit me OJQ, asistentë për FNV dhe mësues mbështetës në shkolla, ngase progresi i fëmijës varet nga ky trekëndësh bashkëpunimi.

Lidhur me pikën e katërt, kemi planifikuar që t'a shqyrtojmë nevojën dhe mundësinë e transferimit të nxënësve me dëmtime të rënda (shumëfishta), nga klasat gjithëpërfshirëse, në Dhomën Burimore në Komoran, por paraprakisht të diskutojmë me psikologun komunal dhe ekipën vlerësuese, duke u bazuar në vlerësimin mbi diagnozat si dhe të diskutohet dhe mirret aprovimi nga prindërit.

Në pikën e pestë, kemi shtruar si çështje për diskutim sigurimin e transportit për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara, kjo ngase me vite radhazi është një nevojë për këta fëmijë që nuk ju është gjetur zgjidhje. Andaj, ne do t'a ftojme drejtorin e DKA-së për të parë mundësitë, që Shtatori të i gjejë me një zgjidhje të re.

Nga ky takim, z. Milaim Hajdari, ka përgëzuar KKPAK për aktivitetet, dhe rezultatet e arritura, si dhe gjatë diskutimit ka ofruar rekomandime praktike dhe mbështetje të vazhdueshme brenda kompetencave, në mënyrë që bashkarisht t'i kontribuojmë cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara.

Meqenëse nuk kishte pika të tjera për diskutim, në orën 15:00, përfunduam mbledhjen.

## Mbledhja e katërt e Komitetit Konsultiv për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 24. 08. 2022

Komiteti Konsultiv për PAK, të mërkurën, gjegjësisht, me datë: 24.08.2022, mbanë mbledhjen e katërt të rregulltë me radhë, duke filluar nga ora 13:00, në zyrën me xhama, në komunë. Kjo mbledhje është udhëhequr, nga zv. kryesuesja Ariana Isufi.

Pjesë e mbledhjes ishin të gjithë anëtarët e komitetit në fjalë, gjegjësisht:

Ariana Isufi  
Shemsi Bërbatovci  
Arlinda Krasniqi  
Jehona Abdyli  
Burim Fazliu

Për të diskutuar bashkë lidhur me çështjet prioritare për këtë komunitet, të ftuar kishim:

1. Lumnije Krapi – Drejtoreshë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
2. Muhamet Gjoka- Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit



**Pikat e rendit të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit, të datës: 27.06.2022
2. Sfidat në qasje infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara
3. Sigurimi i transportit për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara
4. Vizita në secilën shkollë nga ekipa vlerësuese komunale
5. Pajisja me materiale didaktike për asistentët e fëmijëve/ nxënësve me aftësi të kufizuara
6. Të ndryshme

Bazuar në rendin e ditës, lidhur me pikën e parë, gjegjësisht miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, unanimisht jemi dakorduar që aktivitetet e planifikuara, vetëm se kanë filluar dhe po vazhdojnë të përfundohen me sukses, përfshirë bashkëpunimin me Ordinancat Stomatologjike për ofrimin e shërbimeve dentare falas për FNV; planifikimi për mbajtjen e ligjeratave ndërgjegjësuese në shkolla, etj.

Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, e ftuar për të diskutuar më konkretisht lidhur me kontributin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, lidhur me sfidat në qasje infrastrukturore për PAK, kishim drejtoreshën e kësaj drejtorie, znj. Lumnije Krapë, megjithëse, të vetëdijshëm se këto përgjegjësi në masë barten tek Drejtoria për Infrastrukturë, znj. Krapë, ka pohuar se si drejtori, kanë bërë shenjzimin e parkingjeve për PAK, dhe vazhdojnë t'i kontribuojnë këtij komuniteti brenda kompetencave.

Në pikën e tretë, kemi shtruar si çështje për diskutim sigurimin e transportit për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara, kjo ngase me vite radhazi është një nevojë për këta fëmijë që nuk ju është gjetur zgjidhje. Drejtori i DKA-së, z. Gjoka, ka pohuar se për të gjetur zgjidhje më të mirë, duhet të realizohet projekt i veçantë, në mënyrë që edhe ofertat të jenë tërheqëse për operatorin. Megjithatë, ka mbetur që lidhur me këtë pikë, të diskutohet edhe psikologun Komunal, z. Hazir Elshani.

Lidhur me pikën e katërt, që ekipa vlerësuese të dal në secilën shkollë dhe të bëjë vizitat si dhe të bashkëpunohet me asistentët për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara, z. Gjoka, ka premtuar se do të diskutojë me psikologun komunal që të aktivizohen nga shtatori i vitit 2022, në këtë drejtim.

Pika e pestë, ka përmbajtur sigurimin e materialeve didaktike, që vijnë si kërkesa nga asistentët për fëmijë/nxënës me aftësi të kufizuara, për t'a realizuar punën e tyre. Këto materiale, janë speciale dhe të veçanta krahas materialeve që sigurojnë shkollat në përgjithësi, andaj edhe duhet kërkesë e veçantë të drejtohet në DKA, sipas drejtorit z. Gjoka.

Tek të ndryshme, u diskutuan kërkesat e asistentëve për FNV, lidhur me transferimin e këtyre fëmijëve me vështirësi të shumëfishta nga klasat e rregullta në dhomën Burimore në Komoran, por mbetet të vlerësohet nga ekipa vlerësuese nëse këto aftësi janë të nivelit për të bërë transferim, por pa harruar edhe sigurimin e transportit, dhe kushtet tjera të nevojshme.

## Mbledhja e pestë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 28. 10. 2022

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara– Drenas, mbanë mbledhjen e pestë me radhë, me datë: 28.10.2022, në zyrën II me xhama në Komunë.

Mbledhja është thirrur të mbahet nga ora 09:00, ku për të diskutuar bashkë, të ftuar kishim znj. Zahrie Podrimqaku – koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut në komunën e Drenasit.

Mbledhja ka filluar në orën 09:15, ku në këtë kohë të pranishëm ishin vetëm dy nga anëtarët e KKPAK- Ariana Isufi dhe Jehona Abdyli, si dhe koordinatorja në fjalë znj. Podrmiqaku-Subashi. Takimit tonë, ju janë bashkuar edhe anëtarët tjerë si: Arlinda Krasniqi nga ora 09:45, kurse Burimi dhe Shemsiu fare ne fund.

Lidhur me vonesat në takime, është diskutuar për një koordinim më të mirë të anëtarëve.



**Pikat e rendit të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit, të datës: 28.10.2022
2. Bashkëpunimi me koordinatoren e njësisë për të drejtat e njeriut, lidhur me realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për shënimin e datave veçanta për PAK.
3. Bashkëpunimi me DKA për krijimin e një databazë për nevojën për trajnime të asistentëve për FNV- në sindikatën për arsim fillor
4. Identifikimi i kërkesave të shoqatës së të verbërve në Drenas
5. Identifikimi i PAK që kanë nevojë për shërbime fizioterapie, dhe ofrimi i këtyre shërbimeve falas nga fizioterapeut vullnetarë
6. Bashkëpunimi me pediatër dhe ofrimi i shërbimeve pediatrike falas për PAK
7. Monitorimi i aktiviteteve të OJQ-ve përfituese të subvencioneve nga komuna e Drenasit
8. Të ndryshme

- Bazuar në rendin e ditës, lidhur me pikën e parë, gjegjësisht miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, unanimisht jemi dakorduar që çështjet e ngritura janë adresuar me kohë, dhe pritet të nxirren rezultate për detyrat dhe aktivitetet
- Në pikën e dytë koordinatori e njësisë për të drejtat e njeriut, është informuar për aktivitetet e KKPAK , si dhe ideja e saj ka qenë që të koordinohemi që data më e afërt që shënohet për PAK të realizohet me një aktivitet të përbashkët në mes të KK dhe KKPAK. Kjo ide është mirëpritur nga zv. kryesuesja e komitetit në fjalë, dhe ka pohuar lidhur me bashkëpunimin.
- Pika e tretë, rrjedhë nga kërkesa e asistentëve për FNV, të cilët kanë qenë të ftuar në takim nga KKPAK, andaj dhe ky i fundit këtë kërkesë do ta diskutoj me DKA-në.
- Në pikën e katërt, meqë Forumi i AK, ka ftuar në takim shoqatat që operojnë në Drenas për AK si dhe KKPAK, atëherë aty shoqata e të verbërve ka ngritur si çështje një sërë nevojash dhe kërkesash të cilat do të identifikohen dhe specifikohen dhe do të adresohen me kohën tek institucionet kompetente.
- Lidhur me pikën e pestë, KKPAK tashmë ka lidhur bashkëpunim me fizioterapeut me kërkesën për të ju ofruar shërbime falas PAK, kjo vetëm pasi që të identifikohen të tillët që kanë nevojë në të vërtetë.
- Edhe pika e gjashtë, e propozuar nga zv. kryesuesja e KKPAK Ariana Isufi, ka rekomanduar që të lidhet bashkëpunim dhe me pediatër, për ofrimin e shërbimeve pediatrike falas për fëmijët me AK
- Pika e shtatë, thekson monitorimin e subvencioneve të fituara nga OJQ-të dhe shoqatat për PAK nga Komuna e Drenasit, kjo me qëllim të informimit nga afër për aktivitetet dhe shërbimet që ofrohen në kuadër të këtyre projekteve.

Me diskutimin e pikës së shtatë mbledhja u përmbyllë nga procesmbajtësi, Ariana Isufi, në orën 11:00.

## Mbledhja e gjashtë të Komitetit Konsultiv për Personat me Aftësi të Kufizuara

### PROCESVERBAL

Me datë: 07. 12. 2022

Komiteti Konsultiv për Personat me Aftësi të Kufizuara– Drenas, ka realizuar mbledhjen e gjashtë dhe të fundit nga mbledhjet e rregullta për vitin 2022. Kjo mbledhje u mbajtë në javën e parë të muajit dhjetor, gjegjësisht me datë 07.12. 2022, në zyrën II me xhama në Komunë.

Mbledhja është thirrur të mbahet nga ora 09:00, ku të pranishëm ishin anëtarët:

Ariana Isufi

Jehona Abdyli

Shemsi Bërbatovci

Burim Fazliu – ku ky i fundit për shkaqe shëndetësore i është dashur të dal më herët nga mbledhja.

Procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi.



### **Pikat e rendit të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë, të datës: 28.10.2022
2. Identifikimi i PAK të regjistruar si të papunë në zyrën e entit për punësim
3. Identifikimi i numrit të të punësuarve me AK në institucionet komunale, KEK dhe kompani me numër të madh të punëtorëve
4. Identifikimi i nxënësve / fëmijëve më aftësi të kufizuara të përfshirë në kurset dhe trajnimet e “Flutura Academy”, për vitin 2022
5. Bashkëpunimi me QPS për të identifikuar numrin e fëmijëve me AK (aftësi të kufizuara) nën moshën 18 vjeç, të cilët kanë aplikuar për pensione në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021.
6. Bashkëpunimi me zyrën e pensioneve në Drenas, për të identifikuar numrin e personave mbi 18 vjeç, të cilët kanë aplikuar për pensione në vitin 2022
7. Përgaditja e raportit vjetor për vitin 2022
8. Të ndryshme

- Bazuar në rendin e ditës, sa i perket mbledhjes së fundit dhe të rregulltë për këtë vit, ne kemi përmbledhur 7 pika gjithsej.
- Lidhur me pikën e parë ne si KKPAK jemi ende në realizim të këtyre aktiviteteve, andaj mbeten të shihen detyrat dhe rezultatet e përgjithshme.
- Në pikën e dytë, kemi potencuar se do të angazhohemi në sigurimin e të dhënave më konkrete nga zyra e entit për punësim lidhur me shifra të sakta për PAK të regjistruar si të papunë apo punëkërkues në zyrat e tyre.
- Kur i referohemi pikës së tretë për rend dite, ne do të provojmë të takohemi më udhëheqës nga institucione të ndryshme, por përfshirë edhe kompani me numër më të madh të punëtorëve për të identifikuar nëse zbatohet ligji për punësimin e PAK.
- Sa i përket pikës së katërt, në vitin e kaluar i kemi rekomanduar “Flutura Academy” që të përfshijë më shumë fëmijë me AK në kurset dhe trajnimet që realizohen brenda kësaj qendre, ngase nuk kemi parë edhe aq fëmijë të përfshirë.
- Lidhur me pikën e pestë, ne do të bashkëpunojmë edhe me QPS (Qendrën për Punë Sociale) për të siguruar databazën me numrin e kërkesave për pensione nga fëmijët nën moshën 18 vjeç me AK, dhe të krahasohen statistikat me vitet e kaluara.
- Në pikën e gjashtë ne kemi planifikuar të sigurojmë gjithashtu të dhëna nga zyra e pensioneve në Drenas lidhur me kërkesat për pensione nga personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç, dhe të krahasohet numri i tyre me vitin e kaluar.
- Lidhur me pikën e shtatë, ne si KKPAK kemi ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për të përfunduar detyrat dhe aktivitetet për vitin 2022, dhe kemi planifikuar që të mbledhim të dhënat që i kontribuojnë përgjegjësive dhe rezultateve të KKPAK.

Meqenëse nuk kishte pika të tjera për diskutim, mbledhjen e përfundoi procesmbajtësja Ariana Isufi, në orën 10:30.

(III)

**PJESA PËRMBYLLËSE**

**KONKLUZIONE & REKOMANDIME**

Komiteti duke parë rëndësinë e bashkëpunimit dhe nxitjen e tij në realizimin e objektivave të veta, ka siguruar bashkëpunim institucional për PAK, nëpërmjet shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit dhe praktikës më të mirë. Ky raport është një sinjal i qartë se mbi bazën e aktiviteteve tona, kemi hipotetizuar e ngritur objektiva konkrete, kemi aranzhuar takime e vizita në terren me akter të ndryshëm, kemi identifikuar problematika, kemi parë nevojën për ndryshim dhe arritur rezultate konkrete. Andaj, sipas kësaj logjike, kemi ardhur në përfundim mbi nevojën e ngritjes së disa rekomandimeve praktike, të cilat i kontribuojnë nevojës për ndryshime.

**Objektivat e Arritura & Rezultatet**

- ◆ Në aspektin e përgjithshëm kemi arritur që në përpikmëri t'i përmbahemi Udhëzimit Administrativ, në harmoni me të cilin veprimet lidhur me realizimin e punës dhe aktiviteteve tona. Kjo gjithmonë duke e mbajtur të informuar zyrën e Kuvendit Komunal me procesverbalet e mbledhjeve, raportet tre mujore si dhe në takimet e realizuara me kryesuesin e Kuvendit Komunal.
- ◆ Gjithashtu, objektivë kryesorë ka qenë t'i përmbahemi me përpikmëri Planit të Punës, për vitin 2022, dhe nga aktivitetet e realizuara, rezulton se pothuajse të gjitha janë arritur në kohën e planifikuar, madje janë arritur rezultate edhe përtej pritjeve tona.
- ◆ Realizimi i ligjeratave ndërgjegjësuere në shkolla lidhur me diskriminimin, paragjykimin, stereotipet dhe etiketimet ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- ◆ Bashkëpunimi mes KKPAK dhe Ordinancave Stomatologjike në komunën e Drenasit, lidhur me ofrimin e shërbimeve dentare falas për afro 50 persona me aftësi të kufizuara (kryesisht fëmijë).
- ◆ Bashkëpunimi mes KKPAK dhe Ordinancave Fizioterapeutike, për ofrimin e shërbimeve fizioterapeutike falas për afër 7 fëmijë deri më tani, aktivitet ky i cili ka filluar së fundi dhe do të vazhdojë edhe për vitin 2023.
- ◆ KKPAK ka përgaditur dhe lansuar një video informuese/ndërgjegjësuere, lidhur me fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara – ku pjesë e kësaj video ishin edhe anëtar nga HANDIKOS në Drenas dhe Komiteti Konsultativ për mbrojtje të ambientit, shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
- ◆ KKPAK për të shënuar 2 Prillin - DITËN NDËRKOMBËTARE TË AUTIZMIT si datë të rëndësishme, ka shtuar fokus të veçantë në hartimin e një broshure, me titull “DUA TË JEHOJË ZËRI IM”, qëllimi i së cilës broshurë është të nxisë që të gjithë personat me autizëm të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të

nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Andaj, kjo broshurë është ndarë me drejtor, mësimdhënës, nxënës, si dhe është vazhduar me shpërndarjen e tyre në qytet, si kampanjë vetëdijësuese, për nderë të kësaj dite.

♦ Kemi organizuar takime virtuale me Komitetet Konsultative funksionale për PAK të komunave të disa komunave të tjera, nga ku kemi diskutuar dhe shkëmbyer sfidat e përbashkëta, përvojat dhe arritjet e deritanishme.

♦ Bashkëpunimi me akademinë “Flutura” për të trajtuar nga afër përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kurset dhe trajnimet që ofrojnë. Ishte një kërkesë/ rekoamdnim i yni, për përfshirje, andaj mund të theksohet se për dallim nga viti i kaluar, ka një përfshirje të theksueshme të FNV në këtë qëndër, gjegjësisht totali i të gjithë fëmijëve vitin e kaluar ishte diku rreth 300 fëmijë, përderisa për vitin 2022 ky numër ka shkuar në 680, me më shumë se 20 FNV.

♦ Realizimi i takimeve, konsultimeve apo dëgjimeve publike në bashkëpunim me komitetet tjera konsultative në komunën e Drenasit me qëllim të diskutimit, parashtrimit të kërkesave, rekomandimeve dhe kritikave kundrejt detyrave dhe përgjegjësisve të secilit komitet konsultativ, përfshirë edhe KKPAAK.

♦ Bashkëpunimi me Zyrën e Punësimit - ZP në Drenas, për të identifikuar personat me aftësi të kufizuara (AK) të cilët regjistrohen në këtë zyrë si të papunë dhe punëkërkuar. Përkundër përpjekjeve të KKPAAK për të siguruar një databazë nga ZP lidhur me të dhënat e lartpërmendura, ne jemi informuar se për vitin 2021 dhe 2022, nuk është evidentuar asnjë person me AK kjo ngase nuk kanë paraqitur dëshmi mjekësore që dëshmon aftësinë e kufizuar. Si rezultat i kësaj logjike, as HANDIKOS nuk ka arritur të na siguroj një databazë me të dhëna të sakta, përveqëse kemi mësuar se institucionet që kanë punësuar persona me AK janë: Shtëpi e Shëndetit, Komunë, Feronikel, Shkolla, KEK, Polici, Postë, Bankë dhe Kompani e Pastrimit.

♦ Bashkëpunimi me Qendrën për Punë Sociale – QPS, për të identifikuar numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme që realizojnë pensione me shumë prej 100 euro. Nga të dhënat që kemi marrur nga ky institucion, kemi identifikuar se në periudhën Janar-Dhjetor 2022, janë evidentuar gjithsej 32 kërkesa, për dallim nga viti i kaluar ku ishin 36 kërkesa.

♦ Bashkëpunimi me Zyrën e Pensioneve, me qëllim për të identifikuar numrin e personave me AK mbi moshën 18 vjeç që realizojnë pensione të kategorive të ndryshme, përfshirë paraplegjik dhe tetraplegjik ku numri tyre varionte në 15 persona, aftësi të kufizuara fizike dhe mendore që ishin gjithsej 95 persona, persona të verbër ishin 6 si dhe shurdhmemec vetëm 3 persona, që nënkupton se për vitin 2022, gjithsej kjo zyrë ka evidentuar 114 PAK.

♦ Realizimi i tryezës së rrumbullakët, me theks të veçantë në fushën e arsimit, me profesionist të fushës, gjegjësisht me mësues mbështetës, asistentë në shkolla për fëmijë me aftësi të kufizuara. Nga tryeza të tilla, duke shkëmbyer ide dhe përvoja, ne kemi aritur që t'i kontribuojmë përmirësimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies për fëmijët me AK.

- ◆ Vizita në shkolla dhe Dhomën Burimore për të parë nga afër punën, sfidat dhe për të identifikuar nevojën për mjete konkretizuese dhe didaktike.
- ◆ Janë publikuar të gjitha aktivitetet në rrjetin social ne facebook, përkatësisht në faqën e KKPAK, për të mbajtur të informuar qytetarët për arritjet, sfidat dhe bashkëpunimin me akter relevant, lidhur me PAK.

### **Kufizimet**

- ◆ Një nga kufizimet e aktiviteteve tona gjatë këtij viti, është se edhe pse kemi identifikuar barrierat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara, ne si KKPAK edhe pas intervenimeve të nevojshme nuk kemi hartuar ende një program të veçantë për të na shërbyer për vitin 2023 se si të veprojmë konkretisht.

### **Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2023**

- ◆ Inkurajojmë Drejtorinë e Infrastrukturës në identifikimin e gjitha pikave në trotuare ku nuk ka mundësi për lëvizje të lirë, dhe rekomandojmë rregullimin e trotuareve, pjerrinave në rrugë (qytet), për qasje më të lehtë të PAK.
- ◆ Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përkatësisht në kuadër të QKMF-së dhe QMF-ve, rekomandojmë ofrimin e shërbimeve shëndetësore më kohë në zonat rurale për PAK, familjarët e të cilëve parashtrojnë kërkesë paraprakisht me arsyetimin se nuk kanë mundësi t'i bartin ata deri tek institucionet ku ofrohen këto shërbime. Rekomandime të tilla, kryesisht vijnë nga familjarë të personave me AK, drejtuar KKPAK.
- ◆ Inkurajojmë OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale, të realizojnë projekte të cilat mund t'i kontribuojnë ndërgjegjësimit të shoqërisë në përgjithësi lidhur me stigmën ndaj PAK, ngase bazuar nga ligjeratat në shkolla dhe realizimit të aktiviteteve (luajtjes së roleve), kemi parë se kjo stigmë nuk është se ka pësuar zbehje, përkundrazi qëndron në nivel shqetësues.
- ◆ Rekomandojmë personat të cilët kanë një dëshmi mjekësore që dëshmon mbi aftësinë e kufizuar të tyre të paraqiten në Zyrën e Punësimit si të tillë, kjo ngase hezitimi për të shfaqur aftësinë e kufizuar i kontribuon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë mos luftimit të stigmës kundrejt tyre.

### **Planet Prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2023**

Planet prioritare të KKPAK për vitin 2023, pjesërisht përfshijnë rekomandimet e ngritura vitin e kaluar por edhe aktivitetet produktive të filluara në vitin 2022.

Disa prej tyre janë:

- Monitorimi aktiv i implementimit të legjislacionit për PAK
- Sistem arsimor gjithpërfshirës parauniversitar
- Rregullim i infrastrukturës për PAK
- Rritja e numrit të asistentëve dhe mësuesve mbështetës në shkolla
- Luftimi i stigmës kundrejt PAK
- Shërbime shëndetësore cilësore
- Mundësi punësimi për PAK etj.

**Ky raport është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK**

**Anëtarët e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara:**

1. Shemi Bërbatovci (kryesues)
2. Ariana Isufi (zëvendës kryesues)
3. Arlindë Krasniqi (anëtare)
4. Burim Fazliu (anëtar)
5. Jehona Abdyl (anëtare)



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		10.01.2023	
Nj. Org.	Numër	Shitja	Vlera
02	052/01-1680		



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit  
Municipality of Drenas

<i>Për:</i>	Kuvendin Komunal të Drenasit
<i>Cc:</i>	Kryesuesi i Kuvendit Komunal zt. Milaim Hajdari
<i>Nga:</i>	Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
<i>Lënda:</i>	Rekomandimet e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
<i>Datë:</i>	10/01/2023

## Rekomandimet e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022

Gjatë vitit 2022, ne, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi mbajtur gjashtë mbledhje, raportet e të cilave janë dorëzuar më kohë tek personat përgjegjës.

Të gjitha rekomandimet e listuara në këtë raport kanë dalë pas hulumtimeve që kemi bërë, ne, anëtarët e Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe pas takimeve të drejtëpërdrejta me mësimdhënës, drejtor shkollash, prindër, nxënës, student, sportist, udhëheqës të klubeve të ndryshme sportive, udhëheqës të ansambleve, që funksionojnë në komunën tonë, përfaqësues të OJQ-ve, që fushëveprimtari kanë kulturën, rininë dhe sportin, etj. Fillimisht kemi listuar rekomandimet për fushën e arsimit, mandej rekomandimet për fushën e kulturës, rinisë dhe në fund rekomandimet për fushën e sportit.

### Rekomandimet për fushën e arsimit

- DKA t'i shqyrtojë konkurset pa vonesa, sepse në shumë raste procedurat janë tejzgjatuar dhe nxënësit kanë mbetur pa mësimdhënës për një kohë.
- DKA të vazhdojë t'i pajisë shkollat me teknologji dhe mjete tjera të konkretizimit, sepse ende ka shkolla që kanë mungesë të theksuar të mjeteve të konkretizimit. Për më tepër ende ka shkolla, ku mungojnë edhe hartat, të cilat janë më se të domosdoshme për mbajtjen e mësimin në lëndën e gjeografisë.
- DKA të vazhdojë me ndërtimin e sallave sportive në shkolla, sepse shumë shkolla kanë vështirësi në organizimin e mësimin të lëndës së edukatës fizike gjatë periudhës së dimrit.

- DKA ta trajtojë seriozisht çështjen e nxënësve me nevoja të veçanta. DKA përmes psikologut t'i përkrahë shkollat, që kanë nxënës me nevoja të veçanta. Në shumë raste mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave janë ankuar se përkundër kërkesave të tyre në DKA, shkollat NUK janë vizituar nga psikologu. Pra, DKA-ja të shqyrtojë seriozisht trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta drejtëpërdrejt nga psikologu i DKA-së ose të punësojë psikologë me bazë në shkollë, për shkak se disa nxënës kanë nevojë për trajtim të shpeshtë nga psikologu. Po ashtu DKA-ja përmes ekipës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta të bejë vlerësim objektiv të nxënësve duke marrë në konsideratë edhe raportet e psikiatrit dhe psikologut klinik. Në raste të jashtëzakonshme MOS të insistojë në përfshirjen e këtyre nxënësve në shkolla të rregullta, sepse janë barrë e papërbalueshme për shkollën dhe mësimdhënësit, përfshirë këtu edhe mësimdhënësit mbështetës. Po ashtu DKA të sigurojë transport për këta nxënës.
- DKA mundësisht të sigurojë shërbimin pedagogjik-psikologjik për secilën shkollë, d.m.th. të sigurojë psikolog ose pedagog për secilën shkollë të paktën një ditë në javë.
- Po ashtu në zonat rurale ku nuk ka ndriqim DKA të sigurojë transportin për nxënës edhe nëse është distanca më e shkurtë se 4 km, për shkak të rrezikut nga qentë endacak.
- DKA të hartojë një plan të detajizuar për sistemimin e mësimdhënësve ekzistues, sepse viteve të fundit kemi rënie rapide të nxënësve në komunën tonë. Pra, DKA të këtë kujdes me shpalljen e konkurseve për mësimdhënës të rinj, së pari t'i plotësohen normat mësimdhënësve ekzistues apo edhe të shfrytëzohet mundësia e transferimit të mësimdhënësve nga një shkollë në tjetrën. Gjithnjë duke u bazuar në performancën e mësimdhënësit. DKA duhet të këtë kujdes me listën e pagave, sepse numri i mësimdhënësve që janë jashtë listës së pagave është i konsiderueshëm.
- DKA të shfrytëzojë përvojat e komunave përreth dhe ta zgjidhë çështjen e pagesave të shujtave dhe udhëtimit të mësimdhënësve për kohën sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive, sepse realizimi i këtyre pagesave përmes përmbauesve privat po e dëmton buxhetin e komunës së Drenasit.

### **Rekomandimet për fushën e Kulturës**

- DKRS të hapë thirrjen për ndarjen e subvencioneve për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive në fillim të vitit kalendarik.
- Fondet të cilat janë ndarë për kulturë në veçanti janë minimale krahasuar me dikasterin e sportit. Pra, ka diferencë jashtëzakonisht të madhe ndërmjet këtyre dikastereve.
- DKRS të përkrahë OJQ-të, që fokus të veprimtarisë së tyre e kanë aktrimin, e të cilat mund ta luajnë rolin e trupës së teatrit të qytetit, pasi që teatri është votuar nga Asambleja Komonale e Drenasit.
- Komuna e Drenasit të shqyrtojë mundësitë për të ndërtuar një sallë multifunksionale për aktivitetet kulturore në të cilën përfshihen teatri, salla koncertale, muzeu, biblioteka e qytetit, kinemaja, salla për prova teatrale, valle dhe balet, sallë provash për orkestër, galeri punë për artistët vizuel të Drenasit, punëtori për skulptorë, piktorë etj.

- Të themelohet ansambli i qytetit, i cili mund të jetë në varësi të DKRS-së dhe Ministrisë së Kulturës. Kjo çështje tashmë është e rregulluar me ligjet e Kosovës. Në ansamblin e themeluar nga Komuna e Drenasit do të përfshiheshin anëtarët e të gjitha shoqërive kulturore artistike të cilat tashmë ekzistojnë dhe veprojnë në Drenas.
- Të krijohet një hapësirë, muze, për ansamblin ndër më të vjetrit jo vetëm në Drenas por edhe në nivel të Kosovës, Sh.K.A “Shotë Galica”, e cila gjatë gjithë këtyre viteve ka grumbulluar numër të madh të çmimeve, mirënjohjeve, etj. nga festivale kombëtare e ndërkombëtare. Këtë hapësirë do të mund ta shfrytëzonin edhe ansamblet tjera që funksionojnë në komunën tonë.
- Të identifikohen ansamblet aktive në komunën e Drenasit dhe në varësi të punës që ato ofrojnë, numrit të anëtarëve që kanë, të rregullohet edhe ndarja e subvencioneve.
- Të rikthehen festivalet e rëndësishme dhe historike të Drenasit siç janë “Ditët e Humorit”, “Revista Burimore Folklorike”, sepse kanë një rëndësi në rritjen e interesit për artin e bukur folklorik që e kemi si popull e gjithashtu për të sjellë ansamble të ndryshme nga anë e mbanë trojet shqiptare, ashtu siç kanë ardhë në të kaluarën, që nga viti 1962.
- Të financohen më shuma më të mëdha festivalet aktuale që organizohen në komunën tonë, siç janë “Drenasi Fest”, “Muaji i Mërgatës”, “Tingujt e Vendlindjes” etj.
- Të ndahen për çdo fundvit çmime për artistët e dalluar të Drenasit, ngjashëm siç ndahen çmimet për sportistët e vitit.

#### **Rekomandimet për fushën e Rinisë**

- Komuna e Drenas të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së bursave ndërkombëtare për studentët e komunës sonë.
- Komuna e Drenasit të krijojë një fond të veçantë për inovacion dhe teknologji në të cilën të rinjtë tanë do të kenë mundësi të thellohen në atë që është bashkëkohore, teknologjinë, që sot për sot është gati e domosdoshme në pikëpamjen e avansimit të të rinjve tanë.
- Komuna e Drenasit t’i njoftojë me kohë të rinjtë e komunës sonë për grandet dhe subvencionet që ndajnë ministritë, ambasadat apo edhe OJQ-të e ndryshme. Po ashtu t’i informojë ata me procedurat e aplikimit.
- Komuna e Drenasit t’i mundësojë të kenë qasje në objektin e Qendrës Rinore të gjitha OJQ-ve që funksionojnë në komunën tonë e që fokus e kanë rininë.

#### **Rekomandimet për fushën e Sportit**

- Komuna e Drenasit të nxisë bashkëpunimin ndërmjet bizneseve që operojnë në komunën tonë dhe klubeve sportive. DRKS të organizojë takime konsultative me bizneset dhe klubet sportive, meqë tashmë ligji për sponsorizim është në fuqi, t’i njoftojë bizneset për përfitimet e tyre nga ky ligj nëse sponsorizojnë klubet sportive.
- Komuna e Drenasit të vendosë staza për biçiklistë, kështu do të ndikonte në mbrojtjen e mjedisit dhe do të ndihmonte klubin e çiklistëve në veprimtarinë e tyre.

- Të vazhdojë ndërtimi i shumë fushave sportive sintetike në lokalitete të ndryshme në komunën tonë dhe kështu do të nxitën të rinjtë të merren me aktivitete sportive.
- DKRS të sigurojë transportin dhe ushqimin për nxënësit e shkollave pjesëmarrëse në garat e organizuara nga ta. Meqë, mësimdhënësit e edukatës fizike zakonisht ankohen se DKRS vetëm organizon këto gara, ndërsa barra për transport dhe ushqim i bie direkt shkollave dhe mësimdhënësve.
- DKRS t'i përkrahë financiarisht të gjitha turniret e sporteve të ndryshme që organizohen në komunën tonë.

Shpresojmë se rekomandimet tona do të trajtohen seriozisht dhe do të merren si të mirëqena dhe dobiprurëse për arsimin, kulturën, rininë dhe sportin në Drenas.

Komitetit Knsultative për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Drenasit

Gentrit Mulaku – kryetar



Resmije Krasniqi - nënkryetare

Nuhi Nika - anëtar

Zyrafete Morina - anëtare

Robert Nuha - anëtar



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit (Glllogocit)  
Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport



Nr. 02-052101-1680 dt. 10.01.2023

Mbledhjet e Komitetit për KAKRS sipas temave të shqyrtuara dh rekomandimeve të dhëna për Komunën e Drenasit.

Nr.	Temat e shqyrtuara gjatë mbledhjes	Data e mbajtjes së mbledhjes	Rekomandimet për Kuvend.
1	PLANI VJETOR	21.02.2022	NUK KISHTE
2	Kultura	27.04.2022	<ul style="list-style-type: none"><li>DKRS të hapë thirrjen për ndarjen e subvencioneve për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive në fillim të vitit kalendarik.</li><li>Të rikthehen festivale të rëndësishme dhe historike siç janë “Ditët e Humorit”, “Revista Burimore Folklorike etj.</li></ul>
3	Komitetet- AKRS,PAK,ETJ	31.05.2022	<ul style="list-style-type: none"><li>Sigurimin e infrastrukturës për “PAK” në shkolla</li><li>Përfishnja e “PAK” në aktivitetet si Kulturë Rini,dhe Sport.</li></ul>
4	Arsimi	20.10.2022	<ul style="list-style-type: none"><li>DKA t’i shqyrtojë konkursset pa vonesa, sepse në shumë raste procedurat janë tejzgjatur dhe nxënësit kanë mbetur pa mësimdhënës për një kohë.</li></ul>

			<ul style="list-style-type: none"> <li>• DKA mundësisht të sigurojë shërbimin pedagogjiko-psikologjik për secilën shkollë</li> </ul>
5	Sporti, Rini	23.11.2022	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e Drenasit t'i mundësojë qasje në objektin e Qendrës Rinore të gjitha OJQ-ve që funksionojnë në komunën tonë e që fokus e kanë rrinë</li> <li>• Komuna e Drenasit të nxitë bashkëpunimin ndërmjet bizneseve që operojnë në komunën tonë dhe klubeve sportive. Pra, DRKS të organizojë takime konsultative me bizneset dhe klubet sportive, meqë tashmë ligji për sponsorizim është në fuqi.</li> </ul>
6	Komiteti, Rekomandimet	15.12.2022	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekomandimet rreth Arsimit, Kultures, Rinis dhe Sportit</li> </ul>

  
 Gentil Mulaku